

PLANI STRATEGJIK PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL PËR KOMUNËN E TEARCËS

2023 – 2027







Përgaditi departamenti për Zhvillim Ekonomik Lokal
Besim Imeri
Meliha Mustafi

Tearcë, 2022

	Përmbajtja	Fq
	Rezymeja kryesore	3
	Përgjegjësitë e komunave për ZhEL	4
	Hyrje	5
1	Karakteristikat kryesore të komunës së Tearcës	6
1.1	Territori dhe vendndodhja	6
1.2	Karakteristikat gjeografike	7
1.2.1	Relievi	7
1.2.2	Klima	8
1.2.3	Karakteristikat hidrografke	8
1.2.4	Vegjetacioni	9
1.2.5	Fauna	10
1.2.6	Pyjet	11
1.3	Demografija	11
1.3.1	Struktura etnike e popullatës	14
1.3.2	Migrimi i popullatës	15
2	Ekonomia e NJV Tearcë	16
2.1	Karakteristikat ekonomike të komunës së Tearcës	16
2.1.1	BPV në komunën e Tearcës	17
2.1.2	Norma e aktiviteteve të popullatës	17
2.2	Pasqyra e veprimtarive dhe ndërmarrjeve në teritorin e komunës	18
3	Biznis rrethina	21
3.1	Bankat dhe institucionet financiare	21
3.2	Shërbime sigurie në rrethinë	21
4	Politika lokale tatimore dhe shërbime publike	22
4.1	Politika tarimore e e NJVL Tearcë	22
4.2	Planifikimi urbanistik dhe kompenzimet	22
5	Përkrahja e biznis sektorit	24
5.1	Shërbime konsultuese	24
6	Kualiteti i jetesës dhe gjendja e infrastrukturës	24
6.1	Infrastruktura rrugore	24
6.2	Infrastruktura e telekomunikimit	25
6.3	Infrastruktura komunale	26
6.3.1	Rrjeti i ujësjëllsit	26
6.3.2	Kanalizimi dhe ujrat e zeza	26
6.3.3	Sistemi për ujitje	27
6.3.4	Menaxhimi i mbeturinave	27
6.3.5	Rrjeti energjetik	28
6.4	Arsimi	28
6.5	Shëndetsia dhe mbrojtja sociale	30
7	Bujqësia	30
8	Trashigimia tradicionale kulturore-historike	33
9	Sektori civil	34
10	Analiza e situatës	35
10.1	SWOT analiza	35
10.2	Analiza PESTLE	41
10.3	Mendimi publik prej sektorëve të ndryshëm	43
10.4	Vetëqeverisja lokale, organizimi dhe buxheti	48
10.4.1	Struktura organizative e komunës së Tearcës	48
10.4.2	Buxheti i komunës së Tearcës	49
10.5	Përfundimet	51
10.6	Rekomandimet	54
11	Plani strategjik për ZhEL	56
11.1	Vizioni	57
11.2	Misioni	57
11.3	Parimet dhe vlerat	58
11.4	Korniza strategjike	58
	Rezultatet	59
	Literatura	60
	Të ndryshme (Fotografi, lokacione, shtojca …)	61
	Paraqitja tabelare e planit strategjik	64
	Financimi i planit strategjik	86

Rezymeja kryesore

Zhvillimi ekonomik lokal është proces me të cilin udhëheqësit lokal në kuadër të komunës të punojnë së bashku me partnerët e tjerë të sektorit publik, sektorit privat (biznesit) dhe joqeveritar, me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për zhvillim ekonomik, mbrojtje më të mirë sociale dhe krijim të vendeve të reja të punës. Strategjia për zhvillim ekonomik lokal është e bazuar dhe përgaditur me ndihmë dhe informacione nga pjesëmarrja aktive e të gjithë palëve të interesuara të bashkësisë dhe me analiza të theksuara materiale dhe socio - ekonomike. Strategjia i pasqyron kërkesat dhe problemet të cilët janë të identifikuara si të rëndësishme dhe mundësitë të cilat mund t'i shfrytëzojmë me qëllim të përmirrësimit të kualitetit të jetës dhe mirrëqenies. Besojë se kemi arritur që të zhvillojmë qasje logjike dhe strategjike me qëllim që t'i përfshijmë të gjitha pyetjet të cilat janë të fokusuara në sektorët kyç dhe prioritar.

Strategjia është e dizajnuar që të realizon ndikim afatgjatë. Njëkohësihst do të kontribuon drejt rritjes afatgjate ekonomike duke krijuar kushte për territor më të qëndrueshëm në të ardhmen. Me rëndësi të madhe është që në periudhën për të cilën vlen strategjia, duhet të ndërmerren masa dhe të kemi kujdes që më me lehtësi ta tejkalojmë krizën energjetike e cila në vete do të bartë pasojat mbi ekonominë dhe aspektin social.

Planifikimi strategjik si proces, ka për qëllim që t'i kyç të gjitha palët e intersuara relevante dhe së bashku ta përcaktojnë vizionin për të ardhmen, t'i definon dhe t'i vendos në strategjitë zhvillimimore; të përcakton energjinë, të identifikon dhe vendos në funksion resurset e komunës së Tearcës dhe të vendos bazë të shëndosh e cila do të siguron që palët e interesuara pjesëmarrëse në proces të punojnë në qëllimet e përbashkëta.

Në procesin e planifikimit strategjik për zhvillim ekonomik lokal të territorit të komunës së Tearcës u identifikuan nevojat e tanishme dhe të ardhshme të zhvillimit socio-ekonomik dhe në bazë të tyre u definua vizioni, vlerat, qëllimet dhe strategjitë të cilat duhet të japin rezultatet e tyre në plotësimin e nevojave të tyre. Strategjia në kuadër të saj përmban vizionin e definuar për zhvillimin e principeve të përcaktuara për implementimin e strategjisë, qëllimeve strategjike, rezultateve, prioriteteve dhe masave për arritjen e vizionit të përvaktuar nëpërmjet të misionit të tyre. Plani strategjik është i sublimuar dhe sistemuar në mënyrë që të përpunon qëllimet strategjike si dhe lidhjeve dhe korelacionit, nëpërmjet së cilës i paraqet hapat që duhet të ndërmeren në procesin e arritjes së vizionit të saj. Qëllimet strategjike në vete përmbajnë prioritetet të cilat janë përgjigje ndaj sfidave në procesin e zhvillimi të komunës së Tearcës në periudhës 2023 – 2027.

Ndjekja dhe realizimi i masave të përmbajtura nga ana e strukturave udhëheqëse si dhe përkrahja përkatëse financiare nëpërmjet misionit të tyre që siguron arritjen e vizionit dhe besimit, transparencës, efikasitetit, dhënies llogari të komunës së Tearcës për zhvillim të mjedisit rural në të cilën ka edhe kompetenca.

Përgjegjësitë e komunave për ZhEL

Ligji i ri i Vetëqeverisjes Lokale (nr. 05/05, neni 22 pika 3) i njësive për vetëqeverisje Lokale i'u jep përgjegjësi më të mëdha edhe në sferën e zhvillimit ekonomik lokal – ZhEL. Përvec të tjerave, si përgjegjësi e komunës do të jenë: „Zhvillimi ekonomik lokal – planifikimi i zhvillimit ekonomik lokal, caktimi i prioriteteve zhvillimore dhe strukturore; udhëheqje me politikën lokale ekonomike; përkrahje të zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të afarizmit në nivel lokal, dhe në këtë kontekst, pjesëmarrje në vendosjen dhe zhvillimin e rrjetës lokale të institucioneve dhe agjensioneve si dhe promovimin e partneritetit".

Proceset integruese të R. së Maqedonisë për kyçjen në BE krijojnë përgjegjësi shtesë për ndjekjen e modeleve për krijiminin dhe realizimin e ZhEL. Për të punësuarit e komunës kjo është një përgjegjësi e madhe mirepo është edhe kënaqësi të fillohet me procesin e zhvillimit ekonomik nga niveli lokal.

Aktivitetet janë të orientuara rreth përforcimit të kapaciteteve të vetëqeverisjes lokale për ZhEL, shoqërimi i përfaqësuesve të sektorit publik, privat dhe të OJQ-ve me qëllim që të zhvillohen partneritetet, të definohen prioritetet dhe mundësitë në formë të strategjive dhe programeve për ZhEL.

Strategjia është forca lëvizëse e çdo organizate. Është një forcë intelektuale që i ndihmon ata të organizohen, të inkurajojnë aktivitetin e tyre dhe të vendosin qëllime dhe prioritete. Strategjia është mjet i kombinimit të masave, aktiviteteve, financave, mjeteve, resurseve, ideve, kohës dhe shkathtësisë së përpiluesit në arritjen e vizionit ku duam të arrijmë për zhvillimin ekonomik lokal - Besim Imeri

HYRJE

Nevoja për intesifikim e përpjekjeve për rritjen e zhvillimit ekonomik dhe qëndrushmërisë ekonomike të komunës, si pjesë e bashkësisë së komunës së Tearcës, e cila na jep mundësinë që të orvatemi për të përmirrësuar situatën ekonomike.

Profili i komunës siguron informacione dhe pasqyron karakteristikat socio - ekonomike, resurseve natyrore dhe përllogaritjen reale të situatës si dhe paraqet bazë të mirë për zhvillim ekonomik lokal të komunës së Tearcës.

Pas historiatit të shkurt dhe përshkrimit të vendndodhjes gjeografike, resurseve natyrore dhe specifikave të komunës në këtë strategji, sigurohen gjithashtu edhe informacione dhe analiza për demografinë, karakteristikat dhe distribuimi, strukturës arsimore dhe përshkrimi i sektorëve ekonomik të komunës. Në tekstin e mëtutjeshëm si karakteristika kryesore të parashikuara me specifikat e elementeve të infrastrukturës ekzistuese në rrethana biznesore.

Pas kësaj strategjia, gjithashtu është e orientuar edhe kah fushat tjera të shoqërisë, siç janë : bashkësia e njësive të vetëqeverisjes lokale – BNJVL, komuna e Tearcës, Politika sociale, Shëndetësia, Kultura, Sporti, Mediumet, Efikasiteti energjetik etj.

Profili ekonomik, i definuar dhe paraqitur në mënyrën dhe kontekstin e lartshënuar të definuar si bazë mbi të cilën ndërtohen vizioni, qëllimet strategjike- rezultatet dhe qëllimet konkrete, si dhe programet dhe projektet. Duke u bazuar në situatën momentale, e cila është e paraqitur në profilin e komunës së Tearcës, nga kjo mund të përfundohet se ajo është pika fillestare për zhvillimin e ardhshëm lokal, e cila duhet që të arrihet dhe të jetë i definuar. Procesi i planifikimit strategjik, në të cilin qëllimi i strategjisë për zhvillim ekonomik lokal zhvillohet në përputhje me këtë model :

Vizioni për situatën e dëshiruar ekonomike në të ardhmen :

- Rezultati për zhvillimin e qëllimeve specifike;
- Qëllimet specifike për zhvillimin e masave prioritare;
- Programet për realizimin e projekteve,
- Projektet për përmirësimin e gjendjes ekonomike.

Vizioni, përcakton si dhe çfarë dëshirojmë të jetë komuna e Tearcës pas 5 viteve, të definuar si :

“ KOMUNA E TEARCËS DERI NË VITIN 2027, ME PRODHIME KONKURUESE RURALE, TURIZËM TË ZHVILLUAR MALOR, VLERA TRADICIONALE DHE MULTIKULTURORE DHE NDËRTIM TË RAPORTEVE TË PARTNERITETIT ME INVESTITORËT, DO TË JETË VEND ATRAKTIV DHE I ZHVILLUAR EKONOMIKISHT ”

1. KARAKTERISTIKAT THEMELORE TË KOMUNËS SË TEARCËS

1.1 Territori dhe vendndodhja

Komuna e Tearcës ndodhet në pjesën veriperendimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.



Në përbërje të komunës së Tearcës ndodhen 13 vendbanime, katër vendbanime janë kodrinoro-malore, ndërsa vendbanimet tjera ndodhen në luginën e territorit të komunës së Tearcës.



Vendbanimet që ndodhen në territorin e komunës së Tearcës janë fshatrat: **Sllatina, Tearca, Përshefca, Gllogja, Nepreshteni, Leshka, Dobroshti, Odri, Nerashti, Brezna, Varvara, Jelloshniku dhe Përca.**

Komuna e Tearcës si komunë ekzistonte deri në vitin 1965 por që nga viti 1966 sipas Ligjit për organizim territorial i'u bashkua komunës së Tetovës. Komuna e Tearcës është e themeluar sërish që nga viti 1996, sipas ligjit për organizim territorial. Ajo ndodhet në pjesën veriperendimore të R.M.V. e cila përfshin një sipërfaqje prej 136.55 km² në të cilën jetojnë 17.694 banorë nga 25.638 banorë sipas regjistrimit të vitit 2021. Dendësia e popullatës rezidente në komunën e Tearcës është 129,6 banorë për km². Sipas numrit të banorëve dhe sipërfaqes që përfshin komuna e Tearcës njihet si një ndër komunat me madhësi të mesme në Republikën e Maqedonisë.

1.2 KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE

1.2.1 Reliefi

Fushëgropa e Pollogut, është krijuar si pasojë e lëvizjeve të mëdha tektonike pas tërheqjes së Liqenit të dikurshëm të Pollogut që ekzistonte (kah fundi i Neogjenit) si pasojë e lëvizjeve të mëdha tektonike, gjatë zhvillimeve terciare dhe kuaternare të grykës së Dervenit nëpërmjet lumit Vardar deri në detin Egje. Gjatë kësaj faze gjeologjike është formuar reliefi në pjesën e Ballkanit, poashtu edhe relievi themelor në fushëgropën e Pollogut.

Reliefi është me karakter kodrinoro -malor, dhe të njejtin e përbëjnë malet : Mali i Thatë me lartësi mbidetare (1.853 m), dhe Mali Sharrr me lartësi mbidetare (2.748 m).

Pjesët malore në perëndim kanë një vegjetacion të bujshëm dhe maleve u japin një pejsazh të theksuar pyjorë, përderisa pjesa lindore e maleve janë të zhveshura dhe të shkreta (Mali i thatë), përshkak të përbërjes gëlqerore.

Fushëgropa e Pollogut gjendet në lartësi mbidetare 300-600 m dhe karakterizohet me reliev të fushëgropës. Në pjesën e poshtme të fushëgropës gjenden fushat e pasura të Pollogut , me një lartësi mbidetare prej 400 - 461 m.

Në pjesë të ndryshme të fushave lartësitë varijojnë vga vendndodja e tyre ne fushëgropë.

Reliefi i tokës në komunë e Tearcë ka llojllojshmëri dhe formë të ndryshme. Ajo karakterizohet me majat e larta të Malit Sharr të cilët përfshijnë pjesën më të madhe nga teritroi i komunës, si dhe pjesën e rafshtë të fushgropës së Pollogut. Maja më e lartë e Malit Sharr është maja Çaushica me lartësi mbidetare 2 640 m. Në viset e larta malore ndodhen burime të shumta të projeve dhe lumenjëve,të cilat në drejtimin nga veriperëndim-juglindje përgjatë maleve kanë gërryer lugina të thella të shtretërve të lumenjëve deri në pjesën e poshtme të luginave. Me kalimin e tyre në luginë të gjithë lumenjtë rrjedhin në lumin Vardar në teritorin e komunës së Jegunovcës. Nga një numër i shumtë i pjesëve të mëdha dhe të vogla janë me fosile dhe të thata.

Lugina e Pollogut është formuar nga tërheqja e lumit të atëhershëm të Pollogut (nga fundi i neogjenit), duke formuat tarasa grryese në dy-tri nivele të ndryshme , kurse më e larta ndodhet në lartësi mbidetare 980 m.

Përbërja gjeologjike në shpatet e Malit Sharr ndryshon nga pjesët rrafshinore. Në të dyja pjesët në mënyrë sekundare paraqiten minerale që dallohen nga masa kryesore e përbërjes gjeologjike. Shpatijet e Malit Sharr, në masë më të madhe janë të krijuara nga shkëmbinjtë argjilor, jo të qëndrueshëm dhe të ekspozuara ndaj erozionit. Në rrëzë të Malit Sharr gjenden fshatrat Leshkë, Sllatinë dhe Tearcë të cilat janë të pasura me sasi të gëlqeres dytësore të dopozituara nga ujërat minerale.

Sipërfaqja e fushgropës përbëhet prej shtresave të trasha divuliale dhe aluviale që e mbulojnë sipërfaqen e fortë. Materiali aluvial është sjell prej liqeneve malore i cili është i përshtatshëm për pemëtari. Pjesa diluviale (e akullt) përbëhet prej gurëve të mëdhenj që gjenden të shtresuara në shtresat më të thella dhe janë të mbuluara me rërë.

Përbërja e tokës në komunën e Tearcës në të kaluarën disa herë ka qenë lëndë e analizave të here pas hershme. Janë vërtetuar shtresa të oniksit të mermertë në fshatin Leshkë, i cili është i

eksploatuar dhe me siguri është harxhuar. Në shumë vende gjenden edhe shtresa të glinës së kaolinës (betonit). Analizat janë kryer edhe në komunën e Tearcës ku paraqiten shtresa të xehes së pirit dhe limonit.
Analizat më të thella rreth përbërjes së tokës në të ardhmen do të tregojnë se a thua vallë kjo komunë disponon me potenciale të xeheve për eksploatim.

1.2.2 KLIMA

Rajoni i Pollogut ka klime të mesme – kontinentale ditë me shumë diell gjatë gjithë vitit. Vera është e nxehtë dhe pjesërisht me lagështi ndërsa dimri është i ftohtë dhe me borë, pranvera dhe vjeshta karakterizohen me rreshje të shiut. Ngaqë lugina e Pollogut është e rrethuar me male në të ndodhin lëvizje të masave të ngrohta dhe të ftohta të ajrit që ndodhin gjat procesit dhe anasjelltas.
Temperatura mesatare e rajonit të Pollogut sillet reth 11 º C. Gjatë vitit temperaturat në këtë rajon ndryshojnë nga -20 º C deri më + 38 º C. Temperaturat më të larta gjatë vitit janë në muajin korrik dhe gusht , përderisa temperaturat me të ftohta janë në muajt janar dhe shkurt.
Shpejtësia e erës sillet reth 16 m/sek, ndërsa shpejtësia maksimale është 26,5 m/sek. Mjegullat në Pollog paraqiten gjatë dimirit në muajt janar dhe shkurt , kurse shumë rrallë paraqiten në periudhë e ngrohtë të vitit. Në dimër trashësia e borës që mbulon zonat malore arrin 50cm, ndërsa në viset më të larta arrin deri në 1 m.
Komuna e Tearcës është në ndikimin e klimës kontinentale dhe mediterane dhe modifikimeve të tyre. Në vendet e ulta vera është e nxehtë dhe e thatë ,ndërsa dimri i ftohtë dhe me lagështi dhe me temperatur ekstreme. Ndërsa lugina është relativisht me diell.
Kjo klimë ofron mundësi të mëdha për sport dhe rekreacion në natyrë, si gjatë verës ashtu edhe në sezonin e dimrit.
Rreshje të shumta të shiut ka më shumë gjatë stinës së pranverës dhe vjeshtës dhe atë relativisht 750mm. Shpejtësia e erës në vit sillet reth 16 m/sek, ndërsa shpejtësia maksimale është 26,5 m/sek. Më shpesh era frynë nga veriu dhe veriperëndimi.

1.2.3 KARAKTERISTIKAT HIDROGRAFIKE

Territori i komunës së Tearcës është shumë i pasur me rrjedha të përhershme të ujit të cilat kalojnë nëpër përroje dhe lumenj të pasur me ujë gjatë gjithë vitit. Gjatë kohërave me shi dhe shkrirrjes së borës në viset malore nga shpatiet më të larta kemi prurje më të mëdha të ujërave. Hidrografia në luginën e Pollogut është specifike nga numri i rrjedhave të ujit dhe pasurisë me ujra.

Rrjeti hidrografik në komunën e Tearcës është i zhvilluar falë burimeve të pasura të Malit Sharr.

Në atarin e komunës së Tearcës kalojnë 5 lumenjë dhe disa përroje që rrjedhin nga Mali Sharr. Këto lumenj kalojnë nëpër këto fshatra: Nepreshten (lumi i Nepreshtenit), Sllatinë (lumi i Sllatinës), Tearcë (lumi Bistrica), Dobrosht (lumi Gabrovnica) dhe Odri (lumi i Odrit) dhe të gjithë këta lumenjë derdhen në lumin Vardar .
Një ndër lumenjtë më të mëdhenj është lumi i Bistricës me gjatësi prej 19,2 km.
Gjatë verës sasia e ujrave në këto lumenj reduktohet në mënyrë drastike, në pjesën e poshtme të rrjedhës së lumenjëve shtretet e tyre shpesh edhe thahen.

Në viset më të larta të Malit Sharr gjenden disa liqene atraktive edhe atë Liqeni i Dobroshtit të Poshtëm në latësi mbidetare 1 890 metra, Liqeni I Dobroshtit të Epërm me lartësi mbidetare 2 362 metra, Liqeni i Breznës. Këto tre liqene të bukur të quajtur "Sytë e Sharrit" duhet të paraqesin pikë të rëndësishme në të gjitha planet e ardhshme zhvilluese në sferën e turizmit.
Potenciali ujor i Malit Sharr në masë të konsiderueshme është i kaptuar nëpër rezervuare dhe distribuohet nëpër rrjetin e ujësjellsit si ujë për pije për të gjitha vendbanimet. Pjesën e ngelur të ujit popullata e shfrytëzon për ujitjen e sipërfaqeve bujqësore.
Në pjesën e epërme të lumenjëve ka kushte shumë të mira për kultivimin e peshqve e veçanërisht troftës.
Vlen të theksohet se në afërsi të fshatrave Nepreshten, Leshkë, Sllatinë dhe Tearcë ka shumë burime të ujit mineral me kapacitet të ndryshëm. Madje në Sllatinë dhe Leshkë ka tre lloje të tilla. Uji nga njëri burim distribuohet nëpër fshat dhe nëpërmjet çezmës publike arrin deri tek qytetarët.

1.2.4 VEGJETACIONI

Karakteristikat e lloj-llojshme klimatike nga klima e lehtë kontinentale deri te ajo e theksuar malore si dhe shpërndarrjes së terrenit në hapësirë, kushtëzoi një brezë të larmishëm bimorë. Megjithatë shfrytëzimi jo racional i pyjeve, rigjenerimi i paplanifikuar i rrypit të gjelbërt dhe mosmarrja e aktiviteteve të domosdoshme biologjik për pyllëzimin e hapësirave të zhveshura, gjithashtu kanë lënë shenja të tyre mbi vegjetacionin .
Brezi më i lartë i pyjeve përbëhet prej dushkut, ahut dhe dëllinjës. Rajoni me dushk përbëhet nga brezi i shkurreve dhe gërrmushkave. Flora në rrethinë përbëhet nga pyje të pasura me ah ndërsa në sipërfaqet e hapura pyjore janë të pasura me një numër të madh të bimëve mjeksore (kantarion, gentian, trumzë, çaj mali, bar tamith (Achillea millefolium), si dhe fruta mali (si : kerpudha, kaça, thana, dredhëza mali, borovnica).
Mali Sharr është i pasur me 1500 lloje të florës, ndër më të njohura janë: Çaj mali (siderites scardica), pisha (linus peuce), karanfili (dianthus scardicus), zambaku (ilium albanicum) etj.

1.2.5 FAUNA

Në rajonin e Pollogut fauna është autoktone dhe relativisht endemike. Në mesin e shumëllojshmërisë së shpendëve që gjenden në listën e rrallshmërisë natyrore janë: shqiponja e artë (aquilla chrisaetos), shqiponja e bardhë e Sharrit (falkoperegrinus), bufi (bubo bubo), sokoli i përhimtë (falkoperegrinus) dhe thëllëzat etj., kurse prej gjitarëve ariu (ursus archos),risi (lynx lynx), deri i egër (sus strota), dhia e egër (rupicarpa rupicarpa), ujku (canis lupus), lepuri i egër (lepus europeus), dhelpra (vulpes vulpes) etj. Brend i njohur në këtë rajon është "Qeni i Sharrrit ", Lopa autoktone – Busha, Dhia shtëpiake e Sharrit etj.

1.2.6 PYJET

Ekosistemi pyjorë mbulon një pjesë të konsiderueshme të territorit të komunës dhe në të dominojnë pyjet me drunjë gjethrënëse (dushku, shkoza e zezë, shkoza e bardhë, gështenja dhe ahu), gjithashtu edhe pyjet me drunjë gjethëmbajtëse (pisha të zeza dhe pisha skoceze) si dhe pyje të përziera (pisha dhe bredha). Gjatë vitit 2021 më saktësisht më datë 30 qershor 2021 nga ana e Kuvendit të R. së Maqedonisë së Veriut u soll Ligji dhe me këtë pjesa e malit Sharr u shpall si park kombetër. Parku Kombëtar përfshinë 60 % të territorit të komunës së Tearcës.

1.3 DEMOGRAFIA

Sipas regjistrimit të vitit 2002 komuna e Tearcës numëronte 22,454 banorë, ndërsa sipas regjistrimit të Entit Shtetëror Statistikor numri i banorëve në vitin 2021, numëron 25.638 banorë të regjistruar prej të cilëve 17.694 banorë resident.

Dendësia e popullatës – rezidente në territorin e komunës në vitin 2021 është 129,6 banorë në km².

Tabela : Të regjistruar, banorë resident dhe jorezident sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë, , komuna e Tearcës - Regjistrimi 2021

Komuna e Tearcës	Popullata e përgjithshme rezidente		Popullata e përgjithshme rezidente (M + F)	Popullata e përgjithshme rezidente		Popullata e përgjithshme rezidente (M + F)	Popullata e përgjithshme (M +F)
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Gjithsej
Maqedonë	1,078	1,036	**2,114**	113	97	**210**	**2,324**
Shqiptarë	7,351	7,353	**14,704**	4,157	3,458	**7,615**	**22,319**
Turq	206	176	**382**	38	30	**68**	**450**
Romë	23	27	**50**	3	4	**7**	**57**
Vlleh	-	-	**0**	2	0	**2**	**2**
Sërb	10	12	**22**	1	0	**1**	**23**
Boshnjak	-	-	**0**	0	0	**0**	**0**
Tjerë që nuk janë përmendur	11	11	**22**	6	7	**13**	**35**
Nuk janë deklaruar	-	-	**0**	0	0	**0**	**0**
Të panjohur	1	1	**2**	15	13	**28**	**30**
Personat për të cilat të dhënat janë të marra nga burime administrative	171	227	**398**	0	0	**0**	**398**
	8,851	**8,843**	**17,694**	**4,335**	**3,609**	**7,944**	**25,638**


Burimi : EShS , Regjistrimi 2021

	Popullsia e përgjithshme rezidente sipas përkatësisë etnike, sipas vendbanimeve, Regjistrimi 2021											
		Përkatësia etnike - Gjithsej	Maqedonë	Shqiptarë	Turq	Romë	Vllleh	Sërb	Boshnjak	Të tjerë që nuk janë përmendur	Nuk janë deklaruar	Panjohur	Persona përtë cilët të dhënat janë të marranga burime administrative
1	Sllatinë	3.198	0	3.125	0	6	0	0	0	1	0	1	65
2	Tearcë	3.038	778	1.718	376	89	0	7	0	2	0	1	87
3	Nerasht	2.721	2	2.670	0	0	0	0	0	1	0	0	51
4	Dobrosht	2.649	288	2.308	1	0	0	12	0	0	0	0	40
5	Përshefcë	1.923	11	1.871	1	3	0	0	0	0	0	0	37
6	Nepreshten	1.178	330	808	0	0	0	1	0	5	0	0	34
7	Odër	1.175	87	1.044	0	0	0	0	0	0	0	0	44
8	Gllogjë	1.106	230	850	4	0	0	1	0	2	0	0	19
9	Leshkë	696	381	280	0	2	0	1	0	11	0	0	21
10	Varvarë	4	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
11	Breznë	3	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
12	Jelloshnik	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
13	Përcë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Gjithsej	17.691	2.114	14.701	382	50	0	22	0	22	0	2	398

Në mesin e vendbanimeve në komunën e Tearcës është f. Sllatinë i cili sipas regjistrimit të popullissë nga viti 2002 ajo numëronte 4.112 banorë , për momentin sipas regjistrimit të vitit 2021 ai numëron mbi 3.198 banorë rezident.

Popullata sipas vendbanimeve sipas numrit të banorëve dhe përqindjes së banorëve janë të dhëna na tabelë :

	Vendbanimi	Nr. Banorëve	%
1	**Sllatina**	3.198	18,07
2	**Tearca**	3.038	17,17
3	**Nerashti**	2.724	15,40
4	**Dobroshti**	2.649	14,97
5	**Përshefca**	1.923	10,87
6	**Nepreshteni**	1.178	6,66
7	**Odri**	1.175	6,64
8	**Gllogja**	1.106	6,25
9	**Leshka**	696	3,93
10	**Varvara**	4	0,02
11	**Brezna**	3	0,02
12	**Jelloshniku**	0	0,00
13	**Përca**	0	0,00
	Gjithsej	**17.694**	**100**



Burimi : Enti shtetëror për statistikë, Regjistrimi 2021


Tabela Popullata sipas viteve - regjistrimet

viti	1948	1953	1961	1971	1981	1994	2002	2021
banorë	13.233	14.173	15.121	17.732	20.974	20.797	22.454	17.694

Burimi : Enti shtetëror për statistikë, Regjistrimi 2021




Vendbanimi	Sipërfaqja e përgjithshme në ha
Sllatina	627
Tearca	2.969
Nerashtl	949
Dobroshti	2.089
Përshefca	516
Nepreshteni	459
Odri	1.088
Gllogja	411
Leshka	1.000
Varvara	804
Brezna	976
Jelloshniku	951
Përca	816
Gjithsej	13.655




Burimi : Agjencioni për kadastër të patundshmërive i R. së Maqedonisë së Veriut

Popullata e përgjithshme rezidente në Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas grupmoshës 5 vjeçare dhe gjinisë , komuna e Tearcës, Regjistrimi 2021

Tearcë			
	Meshkuj	Femra	Gjithsej
0-4	525	500	1.025
5-9	583	540	1.123
10-14	497	465	962
15 - 19	494	405	899
20 - 24	540	515	1.055
25 - 29	655	622	1.277
30 - 34	771	735	1.506
35 - 39	660	649	1.309
40 - 44	575	536	1.111
45 - 49	498	532	1.030
50 - 54	573	688	1.261
55 -59	671	777	1.448
60 - 64	651	677	1.328
65 - 69	445	455	900
70 - 74	302	312	614
75 - 79	193	196	389
80 - 84	138	145	283
85 +	80	94	174
Gjithsej	**8.851**	**8.843**	**17.694**





Burimi: Regjistrimi 2021, Enti shetëror për statistikë

Nga të dhënat statistikore sjellim këtë konkluzion:

1. Sipas kategorizimit të zonave rurale dhe vendbanimeve në RMV dhe metodologjisë të OECD1 Komuna dhe territori i saj është rural. Numri mesatar i banorëve për kilometër katrorë në gjithë teritorin sillet rreth 129,6 banorë.
2. Sipas të dhënave statistikore në teritorin e komunës ka një përqindje të lartë të popullatës për punë. Megjithatë për të patur një pasqyrë reale këto të dhëna duhet të shihen në kontekst të të dhënave për migrimin të cilat gjithashtu janë të larta. Kjo do të thotë se të dhënat mund të jenë jo të sakta. Popullsia e aftë për punë mund të jetë në përqindje më të vogël ose më të madhe sepse një pjesë e madhe e grave nuk paraqiten në agjencionin për punësim.
   Për momentin në Maqedoni nuk mbahet evidencë e saktë e personave të zhvendosur përkohësisht , turistëve dhe personave të zhvendosur përgjithmonë.

1.3.1 Struktura etnike e popullsisë

Territori i komunës është rajon multietnik dhe multikulturor. Nga analizat statistikore të bëra popullsia e përkatësisë etnike shqiptare mbizotëron në komunën e Tearcës. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë dhe amvisërive në vitin 2021 në komunën e Tearcës duhet të ketë regjistruar gjithsej 25.638 banorë të nacionaliteteve të ndryshme, edhe ate :

Komuna e Tearcës	Popullata e përgjithshme e regjistruar	%	Popullata e përgjithshme rezidente	%
Maqedonë	**2.324**	**9,06**	**2.114**	**11,95**
Shqiptarë	**22.319**	**87,05**	**14.704**	**83,10**
Turq	**450**	**1,76**	**382**	**2,16**
Romë	**57**	**0,22**	**50**	**0,28**
Vlleh	**2**	**0,01**	**0**	**0,00**
Sërb	**23**	**0,09**	**22**	**0,12**
Bosnjak	**0**	**0,00**	**0**	**0,00**
Të tjerë të shënuar	**35**	**0,14**	**22**	**0,12**
Nuk janë të deklaruar	**0**	**0,00**	**0**	**0,00**
Të panjohur	**30**	**0,12**	**2**	**0,01**
Personat për të cilët të dhënat janë të marra prej burimeve administrative	**398**	**1,55**	**398**	**2,25**
Gjithsej	**25.638**	**100,00**	**17.694**	**100,00**

Burimi : Enti Shtetëror për Statistik(Regjistrimi 2021)

1.3.2 Migrimi i popullsisë


Edhe pse të dhënat për migrimin e popullatës që janë në dispozicion nga Enti Shtetëror për Statistikor nga analizat nuk mund të nxjerim një përfundim për arsyet e migrimit sidomos për migrimet, përkatësisht emigrantët që kanë migruar jashtë vendit. Duke marrë parasysh gjendjen e përgjithshme të vështirë ekonomike globale, supozimet çojnë në mendimin se ky trend është shkaktuar pikërisht nga gjendja ekonomike , papunësia dhe kushtet e jetesës.

Tabela e ardhëshme i tregon trendet e migracionit në këtë komunë, për periudhë prej vitit 2016 deri 2021 sipas publikimit të Enti Shtetëror statistikor " Migrimet".

Tearcë	Gjithsej sipas viteve					
	2016	**2017**	**2018**	**2019**	**2020**	**2021**
Qytetarë të migruar	440	141	144	612	937	1230
Migrimi nga vende tjera	283	304	369	336	205	315

Tabela : Pasqyrë e tendencave të migracionit në komuna, Burimi : Enti shtetëror për statistikë, Regjistrimi 2021

Në vitet e fundit trendi i emigracionit është në rritje e sipër kryesisht largimi i të rinjëve për të punuar në vendet perëndimore. Për fat të keq trendi i largimit të popullatës për të punuar është evident dhe ende vazhdon sepse vendet perëndimore të Evropës ofrojnë kushte më të mira për punë, dhe paga me të mira



Nga tabela dhe të dhënat e mësipërme mund të vërehet se trendi i migrimit ka filluar të jetë më i theksuar sidomos pas vitit 2019 dhe vazhdon të jetë me përmasa shqetësuese. Nga ky numër i përgjithshëm përqindja më e madhe paraqet ajo e moshës 18-55 vjeçare e cila është moshë e aftë për punë, personave me arsim të lartë e sidomos sektorit të shëndetësisë.

2 EKONOMIA NË TERRITORIN E KOMUNËS SË TEARCËS

2.1 Karakteristikat ekonomike në territorin e komunës së Tearcës

Rajoni për planifikim i Pollogut ku është vendosur edhe territori i komunës shënon pjesëmarrje më të vogël në prodhimin e brendshëm bruto të Republikës së Maqedonisë me 6,8 % nga totali i BDP1. Emigrimi, humbja e fuqisë punëtore të kualifikuar, ngecja e transformimit strukturor dhe të hyrave të vogla nga investime direkte të huaja të cilët e ngadalsuan transformimin e nevojshëm strukturor për rritjen e punësimit në këtë rajon. Si rezultat i kësaj është shkalla e lartë e papunësisë, gjendje e ndjekur me shkallë të lartë të aktiviteteve ekonomike informale.

Sipas të dhënave zyrtare ekonomia informale e vendit është në intervalin 20% deri 40% nga bruto – prodhimi vendor. Analizat dhe hulumtimet në terren tregojnë përhapje të madhe të ekonomisë informale, ku veçanërisht janë të përfshirë të rinjtë dhe gra .

Sektorë të rëndësishëm ekonomik në komunën e Tearcës janë prodhimi i materialeve ndërtimore , përpunimi dhe prodhimi i produkteve finale nga druri , industria ushqimore , përpunimi i plastikës , përpunimi i aluminit dhe prodhimi i produkteve të tekstilit . Në anën tjetër ky rajon ka në dispozicion tokë punuese në përqindje të vogël me (25%), përderisa pjesa e ngelur e saj shfrytëzohet si kullota (75%). Nga kulturat bujqësore janë të njohur gruri, misri dhe patatja .

Me qëllim që këto inciativa të rriten në mikrobiznese të suksesshme , nevojitet qasje adekuate pwr rajone dhe zona tw ndryshme për planifikim si dhe qasja adekuate për sipërmarrësit e rinj dhe gratë. Qasja adekuate përfshin zhvillimin individual të çdo inicviative ekonomike dhe perceptimin e biznesit nga aspekti i rritjes dhe zhvillimit të tij në 3-5 vitet e ardhshme. Lloji i mbështetjes varet nga sektorët/veprimtaria edhe pse kryesisht i referohet hartimit dhe zhvillimit të prodhimeve, përkrahjes dhe qasjes në treg , marketingut dhe shitjes si dhe mbështetjen e duhur për ndërlidhjen e industrisë ekzistuese në nivel rajonal dhe kombëtar.

Fuqia ekonomike përparsit konkurruese dhe hapja e vendeve të reja të punës në komunën e Tearcës mundësojnë përmirësimin e kushteve ekonomike dhe rritjen e zhvillimit ekonomik në nivel lokal si dhe në të njejtën kohë mundësojnë përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve që jetojnë aty.

Strategjia për zhvillim ekonomik lokal është punuar dhe ka për qëllim ruajtjen traditat , karkteristikat natyrore , trashigimin kulturore dhe historike , konceptin e zhvillimit ekonomik lokal si të veçantë nga të tjerët.

Karakteristikat natyrore siç është pozita gjeografike, resurset natyrore klima dhe sipërmarrjet e bëjnë shumë të veçant zhvillimin ekonomik lokal.

2.1.1 BPV (GDP) në komunën e Tearcës

Nga vlersimet e buxheteve të komunës së Tearcës, norma e rritjes së bruto prodhimit vendor (BPV),edhe atë:

	2016	2021
Të hyra /banorë	7.023	11.148
Shpenzime/ banorë	7.005	12.134

Tabela : bruto prodhimi vendor për kokë banori ,shprehur në denar,burimi llogaria përfundimtare

Të gjitha rajonet tjera kanë bruto prodhim vendor nën mesataren e Republikës së Maqedonisë. Bruto prodhim më të vogël vendor për kokë banori, në krahasim me mesataren kombëtare, rajoni i Pollogut me një indeks prej 47.4, ndër të cilat është edhe komuna e Tearcës.

2.1.2 Normat e aktiviteteve të popullsisë

Sipas Entit Shtetëror Statistikor, normat e papunësisë dhe punësimit të popullsisë në nivel rajonal, tregojnë luhajtje (dallime) në lidhje me nivelin e përgjithshëm të normave në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Kështu sipas regjistrimit të vitit 2021 të dhënat janë të paraqitura në këtë tabelë :

Popullsi aktive dhe joaktive			Popullsi aktive - Gjithsej			Popullsi aktive – Të punësuar			Popullsi aktive – Të papunësuar			Popullsi joaktike		
Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra*
16098	8010	8088	4840	3537	1303	1825	1409	416	3015	2128	887	11258	4473	6785
%	49.8	50.2	30.1	73.1	26.9	37.7	77.2	22.8	62.3	70.6	29.4	69.9	39.7	60.3

Burimi: Të dhënat nga Enti shtetëror për statistikë / regjistrimi i vitit 2002

*Vërejtje (Përqindja e popullatësjo aktive është e lartë, për arsye se një përqindje shumë të vogël të femrave shqiptare janë të regjistruar si joaktive)

Shkalla e papunësisë, sipas regjistrimit e vitit 2021është shumë e lartë 3.015 ose 62,3% prej popullatës ekonomike aktive ndërsa punësimi është 1.825 ose 37,7% .

Gjithsesi, për arsye të ndryshimeve tranzitive të shoqërisë pjesa më e madhe e tyre një pjesë e ekonomisë së zezë e cila në masë të madhe është evidente në komunë dhe regjionit. Një shembull i këtillë paraqet sektorin bujqësor në të cilin pjesa më e madhe prej popullatës rurale realizon të hyra (Pjesa më e madhe e bujqëve janë të regjistruar në regjistrin e Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe ekonomizimit me Ujrat si bujq individual ose ekonomi bujqësore). Me masat të cilat ndërmerren për regjistrimin e tyre pritej që të zvogëlohet papunësia reale në komunën e Tearcës.

Gjatë vitit 2021 u realizua regjistrimi i përgjithshëm me të cilin në mes tjerash u evidentuan të dhëna për popullatën aktive dhe joaktive, të punësuar dhe të papunësuar të cilët janë të paraqitur në tabelë :

Popullatë e aftë për punë - Gjithsej			Popullatë aktive - Gjithsej		
Gjinia - Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjini - Gjithsej	Meshkuj	Femra*
14584	7246	7338	5926	3749	2177
	49.7	50.3	40.6	63.3	36.7


Popullatë aktive – të punësuar			Popullatë aktive – të papunë			Popullatë e përgjithshme joaktiv			Të panjohur		
Gjini - Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjini - Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjini - Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjini - Gjithsej	Meshkuj	Femra
3457	2332	1125	2469	1417	1052	8510	3439	5071	148	58	90
58.3	67.5	32.5	41.7	57.4	42.6	58.4	40.4	59.6	1.0	39.2	60.8


Burimi : Të dhëna nga Enti Shtetëror për Statistikë / Regjistrimi 2021

*Vërejtje *(Përqindja e popullatës aktive është me madhe, për arsye se një pjesë e femra shqiptare nuk janë të regjistruara në Agjencionin për punësim .*

Sipas tabelës së paraqitur më lartë mud të vërehet se në vitin 2002 numri i punëtorëve ishte 1.825 ndërsa në vitin 2021 numri i punëtorëve është 3.457 që d.t.th. se numri i të punësuarëve është rrit për 1.632 ose 47.2%. Rritja e numrit të të punësuarëve është te gjinia femërore edhe ate nga 416 në vitin 2002 në 1.125 në vitin 2021 edhe ate për 709 persona.

Gjithashtu rritje më të madhe kemi te gjinia femërore te popullsia aktive për 874 persona gjejgjësisht për 40,15%.





2.2 Përmbledhje e aktiviteteve dhe bizneseve në komunë

Zhvillimi i sektorit privat në këtë zonë mund të analizohet sipas madhësisë dhe fuqisë ekonomike të ndërmarrjeve të cilat gjenden në këtë territor. Sipas Entit shtetëror për statistikë, ndërmarrjet mikro janë më të zakonshme. Ndërmarrjet që karakterizohen si të vogla janë në vend të dytë të përfaqësuara në komunën e Tearcës. Nga kjo gjendje vijmë në përfundim se në këtë rajon kemi ekonomi me zhvillim të dobët. Tabela jep një pasqyrë për numrin dhe madhësinë e subjekteve ekonomike në komunën e Tearcës.

Subjektet ekonomike aktive sipas madhësisë				
	2022			
	Gjithsej	mikro	të vogla	të mesme
Tearcë	446	352	89	2

Tabela: Subjektet aktive të biznesit, gjendja 20.08.2022 , departamenti pë tatime dhe taksa komunale - Komuna e Tearcës

Në përgatitjen e këtij dokumenti, grupi i punës u përpoq që të identifikoj kompanitë që janë aktive në këtë komunë. Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura ndërmarrjet aktive sipas aktivitetit të tyre që ushtrojnë në territorin e komunës :

Veprimtaria	**Ndërmarrje**
Ndërtimtari dhe materiale ndërtimore	Renova, Shaza Beton, Beton Park, Xhegi Komerc, Kompakt, Bau En EN, Isoterm, Klasik Gips, Putz plast, Zibing
Përpunimi i drurit dhe mobilje	Florida, Goja dizajn, Montana - AS, Elegant, Faktori Mobilje, Euroterm, Mahagon, Drvo dekor, Super Mebel
Industria ushqimore	Greenprodukt, Plus Kompani, Kalliri i art, Tea Kek, Nelina Kafe
Industria e miellit dhe nusprodukteve	Ballkan Tritikum, Sofra, Bereqeti, Amir –Fi kom
Dyer dhe dritare nga PVC	Euroterm, Trim international, Cile plast, Idea door,
Industria për përpunimin e metalit	Shpendi, Askajnak, Rolet 2000, Vule Term
Industria e tekstilit	Dama Feshn,
Tregti dhe shërbime	Buloni, Hajri kom, Evropa 92, Luk Oil, Termoenergji, Hidroterm, Garden grup, Meti Komerc
Shërbime transportuese	Faba Trejd, Nerasht kompani, Agim Turs, Arsimi Kompani,
Hotieleri dhe Gastronomi	Kontrast, Kopenhagen, Panorama, Kalabria, Ulqin, Relaks, Proficio, Kalaja as, Kopenhagen, Manastiri Leshkës, Shtozovalle, etj..
Qarkullimi i brendshmë dhe i jashtëm i shërbimeve dhe mallrave, tregtia me shumicë dhe pakicë, eksport - import, transport, shpedicion dhe shërbime tjera	Mak Tois, Agrotehnika, Alba , Besa , Agim Turs

Tearcë / Viti	**2013**	**2014**	**2015**	**2016**	**2017**
Gjithsej	**290**	**292**	**311**	**352**	**384**
A Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	14	13	16	19	21
B Xehtari dhe nxerrje e gurrëve	1	1	1	1	1
V Industria e përpunimit	42	47	54	61	70
D Furnizimi me ujë; largimi i ujrave; menaxhim me mbeturina; sanimi i mjedisit	1	1	2	2	2
GJ Ndërtimtaria	38	36	42	55	64
E Tregtia në tregti me shumicë dhe pakicë; përmirrësimi i automjeteve dhe motoçikleta	106	109	107	112	115
ZH Transport dhe deponimi	16	13	16	17	17
Z Objekti për vendosje dhe veprimtari për servisim të ushqimit	29	29	34	39	37
X Informacione dhe komunikime	-	-	-	1	3
K Veprimtari profesionale, shkencore dhe teknike	6	6	4	5	7
Ll Vepmtari administrative dhe ndihmëse	1	1	1	2	4

L Qeverisja publike dhe mbrojtje; sigurimi i detyrueshëm social	1	1	1	1	1
M Arsimi	5	5	5	5	5
N Veprimtari të shëndetsisë dhe mbrojtjes sociale	19	21	20	19	20
NJ Rekreacion, zbavitje dhe art	1	1	2	3	5
O Veprimtari tjera shërbyese	10	8	6	10	12

Burimi: Subjekte aktive afariste, gjendja 20.08.2022, departamenti për taksa komunale dhe tatime lokale

Tabela : Përmbledhje e subjekteve të biznesit në komunë sipas sektorëve

Paga mesatare në rajonin e Pollogut

Rajoni verilndor është një ndër rajonet ku popullata ka pagë mesatare vjetor më të ulët. Në tre vitet e fundit niveli mesatar bruto dhe neto paga në rajonin e Pollogut është vazhdimisht në rënie. Vlera e pagës mesatare është si rezultati i punësimit të madh të popullatës në sektorin publik. Pagat e paguara në sektorin privat brenda mikro rajonit janë shumë të vogla. Tabela 11 jep një pasqyrë tabelore e trendeve në nivelin e pagës mesatare vjetore të Rajonit e Pollogut.

Paga mesatare bruto e paguar ,në denarë		**2021**
	Paga mesatare bruto e paguar ,në denarë	3.457
	Bujqësia , pylltaria dhe peshkimi	86
	Miniera dhe gurore	14
	Industri prodhuese	610
	Energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	17
	Furnizimi me ujë; menaxhimi me ujra të zeza ,menaxhimi me aktivitete për ambientin dhe mjedisin jetësor	27
	Ndërtimtari	313
	Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi I mjeteve motorike dhe motocikletave	583
	Transporti dhe depo	92
	Objekte për akomodim dhe aktivitete shërbyese me ushqime	149
	Informimi dhe komunikimi	37
	Aktivitete financiare she aktivitete për sigurim	34
	Aktivitete në lidhje me pasurit e paluajtshme	9
	Aktivitete profesionale, shkencore, teknike	107
	Aktivitete administartive ndihmëse shërbyese	126
	Administrata publike dhe mbrojtja ,sigurime socilae të detyrueshme	435
	Arsimi	424
	Aktivitete të mbrojtjes dhe sigurimit shëndetsor	246
	Art, argëtim dhe rekreacion	75
	Aktivitete tjera shërbyese	69
	Veprimtari të amvisërive si punëdhënës, veprimtari që prodhojnë mallrat ë ndryshëm të cilët kryejnë shërbime të ndryshme për nevojat e veta	-
	Veprtimtari të organizatave dhe trupave ekstateritorijal	1
	Të panjohur	3

Burimi : Enti shtetëror për statistikë , regjistrimi 2021

3. Biznes ambienti

3.1 Bankat dhe institucionit financiare

Banka ,ekspoziturat e tyre ose filijalet, kursimore ose fondacione tjera në territorin e e komunës së Tearcës nuk ekzistojnë. Të tilla funksionojnë në komunën e Tetovës (në qytet) edhe atë;

- TTK Banka
- Halk Banka filijala Tetovë
- Banka ekonomike, filijala Tetovë
- Banka komercijale , filijala Tetovë
- Banka Maqedone , filijala Tetovë
- NLB Tutunska banka , filijala Tetovë
- Pro kredit banka , filijala Tetovë
- Banka Qendrore Kooperative , filijala Tetovë
- Ekspozitura Tetovë Banka Kapitale AD Shkup, filijala Tetovë
- Bnka Silk Road , filijala Tetovë
- Uni Banka , Filijala Tetovë
- E tjera.

Kursimorja : Fulm dhe Mozhnosti , filijala Tetovë

3.2 Shërbime të sigurimit në rrethinë

Kompanitë e sigurimit kyesisht janë të vendosura në qytetin e Tetovës për arsye të frekuentimit më të madh të njerëzve, dhe ata ofrojnë shërbime të ndryshme të shërbimeve të sigurimit, si janë :

- Sigurimi Makedonia – Tetovë
- Grawe
- Evroins sigurimi
- Sigurimi Kroacija
- Sigurimi SAVA
- Sigurimi VINER
- Brokeri Sigurimi i ri
- Eurolink
- Sigurimi Trigllav
- Sigurimi Hallk
- Sigurimi Unika

4. Politika lokale tatimore dhe shërbimnet publike

4.1 Politika tatimore në njësinë për vetëqeverisje lokale - Tearcë

Ndër transferet e kompetencave nga niveli qëndror në atë lokal , decentralizimi fiskal është një nga aspektet kryesore të procesit të decentralizimit të Republikës së Maqedonisë.
Si transfereve nga buxheti i pushtetit qendror janë:

- TVSH – Tatim mbi vlerën e shtuar (5% - 2022, 5.5% - 2023 dhe 6% - 2024)
- TP – tatim personal, (4% - 2022, 5% - 2023 dhe 6% - 2024) prej tatimit personal në të ardhurat personale dhe 100% prej tatimit personal nga personat fizik të cilët merren me veprimtari artizanale
- Dotacione me destinim për shkollat, u takojnë në përputhje me ligjin për financim të njësive të vetëqeversijes lokale (NjVL).

Përveç këtyre dotacioneve, NjVL kanë autonomi financiare (burime vetanake të të ardhurave) në përcaktimin e lartësisë të të dhënave në nivel lokal, edhe ate :

- Tatimet në pronë :
    - Tatimi në pronë (5%)
    - Tatimi në qarkullimin e patundshmërive (3%) dhe
    - Tatimi në trashëgimi dhe dhurata (rend ii dytë i trashëgimisë tatimi është 3%, prej rendit të tretë dhe të mëtutjeshëm, tatimi është 5%)
- Taksat komunale (Ligji për taksa komunale) dhe
- Taksat administrative (Ligji për taksa administrative)

Lartësia e këtyre tatimeve dhe të hyrave tjera në nivle lokal, si dhe efikasiteti në definimin dhe dhënia e lejeve dhe dokumentacionit për hapjen dhe zgjerimin e ndërmarrjeve të reaj ose atyre ekzistuese mikro, të vogla dhe të mesme do të kontribuoj për ngjalljen dhe zhvillimin e ekonomisë lokale në komunën e Tearcës.

4.2 Planifikimi Urbanistik dhe Kompenzimet

Planifikimi urbanistik, veçanërisht në pjesën që ka të bëjë me urbanizimin dhe rregullimin e tokës ndërtimore për nevoja industriale (zona ekonomike) dhe nevoja banimi në territorin e komunës së Tearcës është i një rëndësie të veçantë për zhvillimin e ardhshëm ekonomik lokal.

Komuna e Tearcës ka përgatitur :

- DUVB (Dokumentacion urbanistik për vendbanim) për fshatrat Sllatinë , pjesë nga Leshka dhe Tearcë,
- AP (Akt i përgjithshëm) ekziston për këto vendbanime: Nepreshten, pjesë nga Leshka, Përshefcë, Gllogjë, Dobrosht, Odër dhe Nerasht , por të gjitha duhet të azhurohen .
- PUJV (Plani Urbanistik Jashtë Venbanimit) pjesë nga f. Leshkë,
- Disa Plane Lokale të Dokumentacionit Planor – PLDP, jashtë vendbanimeve nëpërmjet inicijativave në interest ë investitorëve privat.
- Për vendbanimet Përcë, Jelloshnik, Breznë dhe Varvarë nuk ka dokumentacion urbanistik .

Aspektet kryesore për zhvillimin e ekonomisë lokale janë:

- lokacioni I tokës ndërtimore,
- sipërfaqet në dispozicion dhe çmimi për blerjen e tokave ndërtimore ,
- shkalla e urbanizimit (infrastruktura komunale , taksat komunale)
- procedura për ndarjen e tokës ndërtimore ,
- efikasitetin e administrates publike dhe kohën për marrjen e lejeve për ndërtim.

Sipas Ligjit për ndarjen territoriale të R.Maqedonisë dhe zbatimin e bilancit të pjesshëm të pronës dhe tokës ndërtimore të R. e Maqedonisë, nga muaji mars i vitit 2005 në kompetencë të vetëqeverisjes lokale, ngelet edhe përcaktimi i çmimit të tokës ndërtimore. Vlen të theksojmë se kjo pjesë nuk është plotësisht e shpjeguar dhe definuar .

Komuna e Tearcës për nevojat për planifikimin e zhvillimit ekonomik lokal në të ardhmen punon intenzivisht në procesin e rregullimit të tokës ndërtimore, me përpunimin e dokumentacionit urbanistik për vendbanim , me të cilën definohen zonat ekonomike-industriale .

Çmimet për rregullimin e tokës ndërtimore janë:

Kompenzime	**çmimi**
Çerftifikat për zone ndërtimi	300
Çertifikat për plan	550
Leje për ndërtimin e një objekt banimi	1.550
Leje për ndërtimin e objekteve ekonomike	1.550

Taksa komunale	**çmimi/m²**
Rregullimi i tokës ndërtimore për një objekt banimi	120
Rregullimi i tokës ndërtimore për një objekt ekonomik	180

Numri i përgjithshëm i banesave	6.982	100
Banesat e ndërtuara para vitit 1971	1.374	19.68
Banesat e ndërtuara pas vitit 1971	4.106	58.81
Banesat e ndërtuara në vitin 1990 (prej ndërtesave të ndërtuara në 1971) prej 2005	1.603	22.96
Banesat e ndërtuara në vitin 2006 prej vitit 2011	537	7.69
Banesat e ndërtuara në vitin 2012 prej vitit 2021	965	13.82

Numri i banesave sipas regjistrimit 2021.

5. Mbështetja e sektorit të biznesit

5.1 Shërbime konsulente

Në komunën tonë nuk ka institucione për mbështetje të biznesit, inkubatorë biznesi apo institucione për shërbime konsulente. Megjithatë, në nivel rajonal (në qytetin e Tetovës) ekziston Agjencia për Promovimin e Ndërmarrësisë (ESA) dhe disa Shoqata.

Mbështetje për shërbimet bujqësore ofrojnë njësitë rajonale të Agjencisë për mbështetje të bujqësisë – Sh.A. Manastir. Agjencia për mbështetje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural – Tetovë, njësia rajonale e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave - Tetovë.

Shërbime për promovimin e masave për punësim ofrohen nga njësia rajonale e Agjencionit për Punësim -Tetovë.

Shërbimet nga aktivitetet sociale mundësohen nga bashkëpunimi ndërkomunal i institucioneve për shërbime sociale – Tetovë.

Promovimi i masave për nxitjen e zhvillimit ofrohen nga ana e Ministrisë së Ekonomisë.

6. CILËSIA E JETESËS DHE INFRASTRUKTURA

Komuna e Tearcës posedon potencial të kapaciteteve të shfrytëzueshme. Një nga bazat zhvillimore është deridiku edhe infrastruktura cilësore. Në qoftë se nuk kemi infrastrukturë cilësore fizike, transportuese, komunale dhe informativo-komunikimit nuk mund të pritet zhvillim i shpejt dhe i qëndrueshëm ekonomik. Edhe pse në territorin e komunës së Tearcës nuk ka mjedise urbane, afërsi me mjediset më të mëdha si Tetova, qytetin e Shkupit dhe Gostivari njëkohësisht janë të rëndësishëm dhe shumë domethënës për infrastrukturën ekonomike si dhe për zhvillimin e ndërmarrësisë, bujqësisë dhe turizmit.

6.1 Infrastruktura rrugore

Gjatësia e rrugëve rajonale në territorin e komunës së Tearcës është në gjatësi prej 19,5 km dhe kalojnë tre rrugë rajonale edhe atë: rruga rajonale R1203 Tetovë - vendkalimi kufitar Jazhincë (me Kosovën), rruga rajonale R2234 Përshefcë –Jegunovcë –Radushë- Shkup, dhe rruga rajonale R29274 Leshkë – Rataj – Zhelinë

	2011	2012	2013	2014	2015	2016	**2022**
	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej	**Gjithsej**
Tearcë	137km	138km	142km	142km	142km	145km	160km

Në komunën e Tearcës , sipas të dhënave nga Enti shtetëror statistikor , për vitin 2016, rrjeti rrugor lokal ka gjatësi prej 160km, nga të cilat rrugë (asfallt) dhe kubëza (bekatoni) 75 km, makadam 7 km, rrugë të paasfaltuara 23km dhe të tjera 42 km . Ndërsa në vitin 2021 gjatësia ka arrit 160 km nga e cila rritje kemi te asfalltimi dhe kubëzat 15 km.

Rrjeti rrugor lokal është në gjendje relativisht të mirë, me trend të rritjes së mëtutjeshme të cilësisë. Ekzistojnë pjesë nga rrjeti rrugor lokal të cilat për shkak të dëmeve të mëdha paraqesin rrezik potencial për trafikun. Mirrëmbajtja e rrugëve lokale është e pamjaftueshme dhe joadekuate veçanërisht në dimër (kur mbyllen pjesë të rrugëve lokale), parasëgjithash është si rezultat i mungesës së mjeteve financiare. Pjesë të rrugëve lokale, veçanërisht në viset e larta malore janë të paasfaltuara, dhe në periudhë të caktuara të vitit paraqesin rrezikshmëri për lëvizjen e automjeteve të lehta.

Nëpër territorin e komunës së Tearcës kalon rruga rajonale R1203 (Tetovë- Jazhincë) e cila nëpërmjet pikës kufitare në "Jazhincë" lidhet me Kosovën , nëpërrmjet të cilës kalojnë numër i madh i udhëtarëve dhe mjeteve motorike brenda ditës.

Nga trafiku hekurudhor shfrytëzohet linja hekurudhore Shkup - Tetovë - Gostivar – Kërçovë. Stacioni hekurudhor është i vendosur në Ratajë-Leshkë, Tetovë, Gostivar dhe Jegunovcë. Përderisa, kapacitetet industriale kanë infrastrukturën të vet për qasje në linjën hekurudhore .

Trafiku hekurudhor dhe rrjeti i saj janë në gjendje shumë të keqe, çështje me të cilën ballafaqohet i gjithë territori i vendit. Ky lloj i transportit nuk shfrytëzohet si në të kaluarën edhe pse përfitimet nga një rrjet i mirë hekurudhorë do të jenë më të mëdha duke patur parasysh që në Jegunovcë ekziston stacion hekurudhorë.

Në lidhje me trafikun ajrorë, përkrah faktit që nuk ka aeroporte ajrore, lidhja e tyre me aeroportet është relativisht e mirë dhe e shpejtë, veçanërisht me aeroportin e Shkupit, i cili është në largësi prej 50 km dhe aeroporti i Ohrit i cili është në largësi prej 152km nga ky territor. Gjithashtu duhet marr parasysh se edhe aeroporti i Prishtinës është afër nga komuna e Tearcës në largësi prej 98km. Për shkak të gjendjes relativisht tsë keqe të rrugëve qasja në të është e vështirë .

6.2 Infrastruktura e telekomunikacionit

Territori i komunës së Tearcës është i mbuluar me rrjetin e telefonisë fikse dhe telefonisë mobile e cila mundëson qasje në internet, e cila është me rëndësi në zhvillimin e ekonomisë veçanërisht për turizmin. Në të njejtën kohë kjo infrastrukturë është shumë e rëndësishme për cilësin e jetesës së popullatës në këtë territor. Për momentin ekzistojnë operator të shumtë të cilët ofrojnë shërbime të telekomunikimit .

Operatorët të cilët e mbulojnë territorin e komunës së Tearcës me telefoni mobile : Telekom MK, A1 dhe Lajka Mobile.

Operatorë të telefonisë fikse janë : Telekom Mk dhe A1.

Operatorët të cilët ofrojnë shërbime të internetit dhe televizionit nëpërmjet rrjetit optik dhe kabllovik janë : Telekom MK, A1 dhe Telenet.

6.3 Infrastrukturë komunale

6.3.1 Rrjeti i furnizimit me ujë

Gjendja e infrastrukturës komunale në komunën e Tearcës përbëhet prej rrjetit lokal të furnizimit me ujë që është në dispozicion me 95% të familjeve.

Qytetarët e komunës së Tearcës me ujë për pije furnizohen nëpërmjet sistemeve të ndërtuara për furnizim me ujë për pije (rezervoar me ujë), rrjetit primar dhe rrjetit shpërndarës të ujësjellsit nëpër të gjithë vendbanimet. Në kompetencë dhe menaxhim të sistemit të ujësjellsit është NP "HIGJIENA "- Tearcë për momentin vetëm në këto vendbanime : Nepreshten , Leshkë , Tearcë, Odri dhe një pjesë e Dobroshtit (pjesa maqedone). Kohës së fundit gjithnjë më intensive është përpjekja për investime në sisteme të ujësjellsave duke filluar nga rregullimi i kaptimit të burimeve, sjelljes së ujit deri te rezervoaret, rezervoareve për ujë të pijshëm dhe rrjeteve shpërndarëse të ujit. Por, për arsye të zvogëlimit të sasisë së ujit nga burimet e nga ana tjetër rritja e konsumit të ujit për pije imponohet nevoja për ndërtimin e stacioneve për furnizim me ujë për pije edhe nga lumenjtë. Në disa fshatra këto inicijativa zgjidhen me vetëinicijativë ndërsa fshatrat të cilët janë në sistemin e NP Higjiena Tearcë i zgjidh ndërmarrja komunale publike. Për zgjidhjen e këtyre nevojave komuna e Tearcës ka përgaditur disa projekte për disa prej tyre është aplikuar e për disa jo. Shumë projekte të kësaj natyre janë të përfunduara dhe janë në funksion prej fondeve të ndryshme nacionale dhe ndërkombëtare, buxheti i komunës së Tearcës dhe vetëkontributi i banorëve.

6.3.2 Kanalizimi dhe ujrat e zeza

Për dallim nga shërbimet e furnizimit me ujë, rrjeti i furnizimit me ujë , grumbullimi dhe kullimi i ujrave të zeza është në nivel të pakënaqshëm.

Qasje në sistemin e kanalizimit dhe pastrimit të ujrave të zeza kanë 0% e familjeve .

Kanalizimi në komunën e Tearcës. Në komunën e Tearcës, nuk ekziston sistem i kanalizimit për ujrat e zeza. Banorët e komunës së Tearcës këtë problem e kanë zgjidhur me ndërtimin e gropave septike të ndërtuara në afërsi të shtëpive. Ujin nga zbrazja-pastrimi i këtyre gropave septike qytetarët më së shumti e shfrytëzojnë për plehërimin e kulturave bujqësore, por në mënyrë të pakontrolluar dhe shpeshherë ajo hudhet edhe në lumenjt. Duke pasur parasysh se një pjesë e madhe e gropave septike janë më të vjetra se 20-30 vjet , funksionimi dhe mirrëmbajtja e tyre është e vështirë dhe e pamundur. Ndërtimi i gropave të reja septike për një pjesë të madhe të familjeve paraqet problem financiar ose problem në aspekt të hapsirës (vendit) për ndërtimin e tyre.

Për zgjidhjen e përhershme të këtij problemi me prioritet për komunën tonë, janë përgatitur projekteve për ndërtimin e rrjetit për kanalizim , azhuruar gjatë vitit 2017-2018. Në bazë të këtyre projekteve është realizuar edhe revizion nga ana e shtëpive të licencuara reviduese. Nëpërmjet fondit për dokumentacion teknik të shpallur nga ana e UNDP dhe Ambasadës Suedeze u siguruan mjete financiare për ripërpunim dhe zgjerim të dokumentacionit teknik për largimin e ujrave të zeza për f. Përshefcë dhe f. Gllogjë me impiant të pastrimit të tyre i cili përfundoi në vitin në vitin 2021. Gjatë vitit 2021 ka filluar edhe ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në f. Tearcë dhe ndërtimi do të përfundoj në vitin 2023. Mjetet për realizimin e këtij

projekti janë të siguruara nga ana e Ministrisë për Mjedis Jetsor dhe planifikim hapësinor me projeksion financiar trevjeçar.

Në komunë nuk kemi kanalizim për ujra atmosferik, ndërsa ujrat atmosferik notojnë lirshëm mbi sipërfaqe dhe kanalet e hapura egzistuese .

6.3.3 Sistemi për ujitje

Në komunën e Tearcës rreth 2 400 ha janë tokë punuese dhe ka nevojë për ujitje. Nga këto momentalisht ujiten vetëm 600 ha edhe atë nga uji i lumenjëve të cilat kanë ujë vetëm në muajin qershor deri në muajin dhjetor. Sipërfaqet e ujitshme në mënyrë drastike janë zvogëluar përshkak të mosfunksionimit të kanaleve që janë të papastruara , mbuluara (zënë) .
Sistemi i rrjetit të kanalizimit Radiovcë - Bistricë, i cili nëpërmes komunës kalon me një gjatësi prej 10 km, por nuk është në funksion mbi njëzet vite. Ndërmarrja publike e cila ishte përgjegjëse për mirëbajtjen e saj është likuiduar. Derisa funksiononte rrjeti i kanalit për ujitje janë ujitur rreth 1 300 ha sipërfaqe tokë bujqësore. Mungesë më të madhe për ujitjen me ujë të sipërfaqeve bujqësore vërehet në vendbanimet Nepreshten, Sllatinë, Tearcë dhe Përshefcë. Në këto fshatra është i domosdoshëm rrjet i kanalit për ujitje deri tek tokat bujqësore të punueshme si dhe sanimi i atyre ekzistuese nga rrënimi dhe mbulimi me mbeturina të ngurta.

Hedhja e pakontrolluar e mbeturinave e ndot ambientin jetësorë. Për momentin problem më të madh paraqet hedhja e mbeturinave nga materialet ndërtimore , të cilin e hedhin kudo. Për ujitjen e një pjese të kulturave bujqësore në sipërfaqe të vogla uji shfrytëzohet nga sistemi rajonal Radiovcë –Bistricë, në gjatësi prej 2,2 km. Me këtë sistem ujiten 380 ha edhe atë 7,96% prej gjithsej tokës punuese. Pjesa e ngelur e tokës punuese ,ujitet nga një numri I madhi burimeve dhe përrojeve.

Në lidhje me furnizimin , shfrytëzimin dhe mbrojtjen e ujrave nga ndotja në industri dhe miniera, kemi të dhëna statistikore vetëm në nivel për të gjithë rajonin e Pollogut .

Në rajonin e Pollogut ujitja e tokës bujqësore kryhet me ndihmën e sistemit për ujitje t.q. kanale për ujitje. Uji për ujitjen e tokës bujqësore merret nga lumenjtë që rrjedhin nëpër fshatrat e territorit të komunës së Tearcës.

6.3.4 Menaxhimi i mbeturinave

Në komunën e Tearcës nuk egziston N.P. për menaxhim me mbeturinat, por këtë e kemi zgjidhur me dhënien në PPP si konsesion të ndërmarrjes ”Eko B-S Building - Bogovinë”. Koncesioneri bën mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave deri tek deponitë publike. Me mbledhjen e organizuar të mbeturinave, janë të mbuluara 9 nga gjithsej 13 vendbanime . Në komunë nuk funksionojnë edhe Ndërmarje Publike Komunale (NPK) të tjera të cilat menaxhojnë me mbeturinat. Mbeturinat (mbetjet) mblidhen dhe barten nga ana e konsesionerit dhe deponohet në deponinë publike Rusino dhe sipas nevojës Drislla të shpallura si deponi publike legale. Koncesioni është me afat kohor prej 12 vitesh gjegjësisht deri në vitin 2034.

6.3.5 Rrjeti energjetik

Territori i komunës së Tearcës është i mbuluar 100% me energji elektrike dhe është nën kompetencat e EVN Maqedoni – njësia punuese Tetovë. Një ndër problemet që paraqitet është rrjeti i vjetëruar i energjisë elektrike dhe në disa pjesë tensioni bie përshkak të mbingarkesës.

Të gjitha vendbanimet në komunën e Tearcës janë të mbuluara me rrjet të energjisë elektrike. Te amvisëritë gjatë viteve të fundit vërehet rritje e shpenzimeve për energji elektrike prej 3% në vit. Ky trend i rritjes vjen si rezultat i uljes së tensionit të energjisë elektrike, i cili bie deri në 160 volt në disa pjesë të vendbanimeve. Problemi i kësaj fushe ndjehet shumë tek qytetarët dhe është e dukshme, dhe situata bëhet alarmuese. Elektroekonomia e Maqedonisë duhet që në periudhë sa më të shpejt të ndërhyjë në mënyrë që të permirësojë cilësinë e furnizimit menergji elektrike në komunë.

Infrastruktura energjitike përbëhet prej 48 trafostacioneve në 13 vendbanime. Rrjeti i energjisë i takon kompanive EVN, MEPSO dhe EEM.

Në territorin e komunës së Tearcës ka të ndërtuar disa mini hidroelektrana , edhe ate :

- Lumbardhi (Lumi Bistricë), Tearcë – 3 mini hidorelekratana me kapacitet të instaluar : nr. 97 - 2,64MW, nr. 98 - 3,2MW, nr. 99 – 3,28 MW (Sol Hidropauer SHPKPV Shkup)
- Lumi Gabrëvnicë (Shkozës), Dobrosht – 2 mini hidorelekratana me kapacitet të instaluar : nr. 103 – 1,8 MW (NORD ENERGY GROUP SHPKPV eksport-import Tetovë), shtrati i lumit Gabrëvnicë – 1,24 MW (ANI- ENERGETIK SHPK Tetovë)
- Lumi Odrit, Odër – 2 mini hidorelekratana me kapacitet të instaluar: nr. 105 - 0,360MW dhe nr. 106 – 0,306 MW (Super Nouva Energy SHPKPV Tetovë)

Gjatë vitit 2022 çmimi i energjisë e me këtë edhe i energjisë elektrike në mënyrë drastike u rritën. Sasitë e pamjaftueshme të energjisë elektrike nga prodhimi vendor dhe varësia nga importi e imponon nevojën dhe interesin për ndërtimin e centraleve fotovoltaike në kulmet e objekteve industrial dhe të banimit. Por, për këtë aktivitet është e nevojshme që të përshtatet edhe rrjeti elektrodistibuiv për pranimin e tepricës së energjisë elektrike nga këto objekte, dhe si e dyta është e nevojshme që të lehtësohen procedurat për ndërtim dhe vendosje të centraleve fotovoltaike me qëllim tu mundësohet investitorëve në objektet e banimit dhe ato industriale t'i instalojnë këto central në varësi prej sipërfaqeve pa kufizim të kapacitetit instalues.

6.4 Arsimi

Arsimi në komunën e Tearcës ndiqet vetëm në shkolla fillore, mësimi zhvillohet në gjuhë shqipe , maqedonase dhe turke. Komuna e Tearcës ka gjithsej 8 shkolla fillore nga të cilat 5 janë qendrore dhe 3 janë periferike. Numër më të madh të nxënësve momentalisht ka Sh.F.K. " Eqrem Çabej" – Sllatinë. Shkollat fillore janë të vendosura në vendbanimet e komunës edhe atë:


- Sh.F.K . "Eqrem Çabej " – Sllatinë
- Sh.F.K .P "Eqrem Çabej " - Nepreshten
- Sh.F.K . "Kiril Pejçinoviq " – Tearcë
- Sh.F.K .P "Kiril Pejçinoviq " – Leshkë
- Sh.F.K . "Asdreni" - Gllogjë

- Sh.F.K . “Faik Konica “ - Dobrosht
- Sh.F.K .P “ Faik Konica “ - Odër
- Sh.F.K . “Ismail Qemali “ - Nerasht

Numri i nxënësve që ndjekin arsimin fillor në komunën e Tearcës për vitin shkollor 2020/2021 është 1.796 nxënës , me 124 paralele gjithsej në 8 shkollat fillore.

	2005/2006	2012/2013	2013/2014	2014/2015	2015/2016	2016/2017	2020/2021
Gjithsej	2,839	1,730	1,643	1,625	1,588	1,606	1796
Nxënës	1,343	819	749	761	729	751	937
Nxënëse	1,496	911	894	864	859	855	859

Burimi: Enti shtetëror statistikor. Gjithsej popullatë aktive në arsimin (rregullt) formal, sipas shkallës së arsimit, gjinisë dhe moshës, sipas komunave, Regjistrimi 2021



Për arsye se në komunën e Tearcës nuk ekziston asnjë shkollë e mesme, nxënësit i ndjekin arsimin e e mesëm dhe i shfrytëzojnë shkollat e komunave tjera.

Arsimi i mesëm			**Arsim i lartë**		
Gjinia - Gjithsej	**Meshkuj**	**Femra**	**Gjinia - Gjithsej**	**Meshkuj**	**Femra**
727	413	314	731	297	434

Në raport me shkallën e arsimimit, sipas të dhënave nga regjistrimi i vitit 2021 shkalla e arsimimit të popullatës sipas gjinisë dhe moshës prej 15 e më shumë vjet, për rajonin e Pollogut ajo është 80,6%

Komuna e Tearcës	**Të arsimuar**			**Të paarsimuar**			**Të panjohur**		
	Gjinia - Gjithsej	**Meshkuj**	**Femra**	**Gjinia - Gjithsej**	**Meshkuj**	**Femra**	**Gjinia - Gjithsej**	**Meshkuj**	**Femra**
Grupëmosha - Gjithsej	14263	7135	7128	167	38	129	154	73	81

Burimi : Enti shtetëror për statistik, popullësi rezidente në moshën mbi 15+ sipas arsimimit dhe gjinisë në komuna , Regjistrimi i vitit 2021

6.5 SHËNDETSIA DHE MBROJTJA SOCIALE

Në fushën e shëndetsisë, në komunën e Tearcës deri në vitin 2022 funksionojnë 18 institucione shëndetësore private – mjekësi e përgjithshme, 13 ordinanca stomatologjike, 6 barnatore dhe të ngjashme në 9 – të venbanime dhe një punkt shëndetësor në shtëpinë shëndetësore rajonale të Tetovës me seli në f. Tearcë. Në f. Leshkë funksionon edhe spitali i ri për sëmundje të mushkërive i ndërtuar në vitin 2007.

Në komunën e Tearcës nuk ka asnjë çerdhe për fëmijë ose shtëpi për persona të moshuar. Por, duhet theksuar fakti se shihet qart deficit i këtyre institucioneve, por edhe arsyetimi për gjendjen e këtillë mund të gjendet edhe në atë se në mjedise rurale shumica e familjeve jetojnë në një amvisëri, gjegjësisht ku dy ose tre gjenerata jetojnë bashkarisht, me çka mundësia për kujdesjen e fëmijëve në kuadër të familjes është e madhe. Kohës së fundit tendenca e këtillë e zvogëlimit të anëtarëve të një familje dhe me këtë nevoja për çerdhe, shtëpi për persona të moshuar, qendra për qëndrim ditor dhe të ngjashme është më të vërtet e domodoshme, nga ana tjetër ky fakt është se jeta dita ditës bëhet më dinamike.

Duhet të theksojmë se është i dukshëm deficit i këtyre institucioneve, shpjegimi për këtë situate ndoshta mund të gjendet në të se shumë familje në mjediset rurale jetojnë në një shtëpi ,ku nga dy ose tre gjenerata ende jetojnë në bashkësi, me të cilën mundësia për ruajtjen e fëmijëve brenda familjeve është e madhe. Gjithashtu, hapja e këtyre institucioneve paraqet problem financiar për komunën, përshkak të numrit të vogël të fëmijëve që jetojnë në territorin e tyre dhe ndarja e mjeteve financiare për mirrëmbajtjen e këtyre institucioneve do të jenë të larta.

Në rajonin e Pollogut nuk egziston asnjë institucion publik ose privat –shtëpi për të rritur (pleq) ,për këtë arsye banorët e këtij rajoni që dëshirojnë t'i shfrytëzojnë këto shërbime shkojnë në institucionet si për shembull në – Shkup.

Me qëllim që tu mundësohet shërbimi i këtillë përsonave të moshuar dhe raskapitur, komuna e Tearcës në bashkëpunim me OJQ "Milenium", komunën e Jegunovcit dhe komunën e Zhelinës realizohet projekti " Përkujdesje e personave të moshuar në kushte shtëpie", i financuar nga ana e Ministrisë për punë dhe politikë sociale nëpërmjet të huasë së destinuar prej Bankës Botërore.

7. BUJQËSIA

Rajoni I Pollogut disponon me 168 701 ha tokë bujqësore nga e cila 24,87% ose 41 963 hektarë janë sipërfaqe punuese, ndërsa 75,12% ose 126 737 hektar janë kullota .

Nga kjo, komunës së Tearcës i takojnë 8.629 ha, prej të cilave 4.777 ha janë sipërfaqe punuese ose 55,34% nga sipërfaqja e përgjithshme. Tabela e radhës jep një pasqyrë të tokës bujqësore , sipas të të dhënave nga Enti Shtetëror për Statistik për vitin 2021 nga MakStat baza.

Tabela Sipërfaqja bujqësore sipas kategorisë së shfrytëzimit në ha, 2018

Sipërfaqe bujëqësore	Tokë e punueshme dhe kopshtet	Pemishtet	Vreshta	Livadhe	Toka e përgjithshme punuese	Kullota
8.629	3.316	118	24	1.319	4.777	3.851

Burimi*: ESHS, web portali, Baza e të dhënave* - MakStat.

Në f. Tearcë në vitin 2021 ka filluar ndërtimi i sistemit të ujitjes në kuadër të projektit " Sisteme të vogla të pranueshme ekologjike për ujitje, me shpenzime të ulta" i financuar nga ana e Bashkimit Europian nëpërmjet mjeteve nga programi IPA. Sipas projektit gypat janë projektuar për ujitjen e 335 ha sipërfaqe bujqësore. Furnizimi me ujë i këtij sistemi do të jetë nga lumi Bistrica (Lumbardh).

Në komunën e Tearcës , në 20 vitet e fundit, vërehet rënie e sipërfaqeve të mbjellura bujqësore , përshkak se nuk kanë përfitime ekonomike në bujqësi. Kjo ka një ndikim negativ në fuqinë ekonomike të banorëve.Sipërfaqet bujqësore shumë pak punohen përshkak çmimeve të ulta të prodhimeve bujqësore, mosegzistimi i organizuar i vendeve grumbulluese, si dhe si dhe mungesa e kapaciteteve për përpunimin e prodhimeve bujqësore dhe në blegtori .

Toka punuese është e vendosur kryesisht në luginën e pjesës së poshtëme të pollogut dhe pjesa më e madhe e kësaj zone ujitet. Kulturat kryesore që prodhohen janë :misër, grurë dhe elb etj.

Tabela Sipërfaqe të mbjellura me kulturat e drithit në ha, 2018

Grurë	Thekër	Elb	Tërshërë	Misër
782	18	24	3	869

Burimi*: ESHS, web portali, Baza e të dhënave* - MakStat.

Pjesën më të madhe të tokës së mbetur e përbëjnë kullotata e larta.Gjegjësisht ,rreth një e tretat e këtij vendi është malorë me male të larta ,ndërsa dy të tretat e tokës janë të vendosura në pjesën kodrinore të luginës.Në komunat rurale dhe në komunën e Tearcës bujqësia është shumë e përfshirë si degë ekonomike.Nga sipërfaqja e përgjithshme e tokës punuese prej 3.793 ha kultura të mbjella bujqësore janë rreth 3.436 ha.

Sipërfaqet bujqësore para 25 viteve ishin të punueshme rreth 97%, ndërsa tani përqindja e sipërfaqeve punuese është 80%. Për shkak kushteve klimatike të favorshme prodhimi i perimeve që dominojnë janë:domatja, specat, patatja, lakra, grosha, bostani (shalqi dhe pjepër). Tek bimët furagjere, nga prodhimi I përgjithshëm me jonxhë janë reth 53%, pjesa tjetër është tërfil, bizele furagjere , misri dhe panxhari. Kultivimi i pemëve (molla, dardha ,ara, qershi dhe etj.), është gjithashtu i rëndësishëm për prodhimin bujqësor.

Tabela Sipërfaqe të mbjella me kultura kopshtare në ha, 2018

Patate	Qepë	Hudhër	Bizele - kokër	Lakër	Domate	Speca	Shalqi
118	13	9	6	27	21	34	32

Tabela Sipërfaqe të mbjella me kultura furagjere në ha, 2018

Detelinë	Jonxhë	Graor	Bizele për kafshë	Misër foragjer	Rrepë foragjere
63	434	13	11	15	39

Tabela Numri i përgjithshëm i drunjëve sipas të mbjellave me pemë, 2018

Qershi	Visnjë	Kajsi	Ftoj	Mollë	Dardha	Kumbulla	Pjeshka	Arra
3.290	1.400	120	640	31.170	3.430	4.940	830	4.190

Burimi*: ESHS, web portali, Baza e të dhënave* - MakStat.

Prodhime kryesore blektorale janë mishi i qengjit, deles , lopës dhe vezët. Gjendja momentale në bujqësi është e ngarkuar me shumë problem, siç janë: copëzimi I sipërfaqeve bujqësore dhe nevoja për shfrytëzimin e saj në mëyrë efektive, cilësia e dobët e pajimeve dhe nevoja për modernizimin e tyre si dhe degradimi i tokave. Në komunën e Tearcës shpesh ndodhin edhe vërshime, në sipërfaqet punuese të tokës edhe atë në vendbanimet Sllatinë, Tearcë dhe Përshefcë edhe atë gjatë muajve në pranverë, ku lumenjtë janë me kapacitet më të madh për shkak të shkrirjes së bores në viset e larta malore.

Blegëtoria si degë ekonomike është mesatarisht e zhvilluar. Gjedhet e mëdha dhe të imta më së shumti ruhen për nevoja të tyre , gjegjësisht për prodhimin e mishit, qumështit , leshit dhe vezëve. Kapacitete për përpunim të prodhimeve blektorale në komunë nuk kemi. Fermerët më të mëdhenj sasitë e mëdha të qumshtit i shesin në qumështoret e komunës së Tetovës. Ekonomit familjare të komunës së Tearcës aktualisht mbajnë rreth 1 500 lopë, 5 100 dele, 300 derra, 2000-3000 pula dhe një numër i vogël i kuajve. Busha është lloj i veçantë i lopës e cila ndodhet në viset e larta malore. Në 50 vitet e fundit , ky lloj është i kryqëzuar me shumë lloje tjera të kafshëve. Përveç Bushës më të njohura janë edhe llojet e kafshëve : frizer dhe simental.

Tabela Numri i bagëtive etj. (Regjistrimi i bujqësisë 2007)

Gjedhe	Kuaj	Dele	Dhi	Derra	Shpezë	Lepuj	Zgjoje bletësh
3.883	280	7.960	662	965	22.482	104	1.803

Burimi*: ESHS, web portali, Baza e të dhënave* - MakStat.

Përveç kafshëve, në blegtori janë të njohura dhe delet pramenka dhe dhitë shtëpiake. Vaksinimi bëhet në të gjitha familjet të cilat ruajnë kafshë dhe kafshët rregullisht vaksinohen. Kafshët ushqehen me ushqime natyrale nga prodhimet bujqësore (misër, jonxhë, barë, grurë, elb, sillazh nga misri etj). Në komunën e Tearcës punon ambulanca e veterinarisë "Vet –Tearce".

Vlen që të theksohet se gjatë viteve të fundit fondet në blegtori kanë rënie prej 80% përshkak përfitimeve të ulta në blegtori dhe mungesa e plasmanëve për prodhimet blegtorale . Në përgjithësi në komunën e Tearcës në masë të gjërë banorët e mikro rajoneve merren me bujqësi sepse nuk ka mjedis urban. Gjithashtu vlen që të theksohet se numri më i madh i banorëve, përveç punës së përhershme në institucionet publike ose private , merren me aktivitete shtesë në bujqësi këto të dhëna pritet që në të ardhmen të kenë karakter të vlerave reale të punësimit dhe GDP në mikrorajon.

Si problem i përgjithshëm është se ndarja e sipërfaqeve punuese u takon bujqëve individual. Këto mikro-ferma mundësojnë plotësimin e nevojave themelore të banorëve por shkaktojnë problem sa i përket konkurrencës me rajonet tjera që në kohë më të gjatë është e paqëndrueshme. Coptimi i parcelave punuese bujqësore në rajon nuk mundësojnë rritjen e ekonomisë së vëllimit në bujqësi në të njejtën kohë reduktojnë efikasitetin dhe produktivitetin e vetë fermerëve. Nga këto arsye, në pjesën e konkluzave dhe rekomandime do të propozohen ndryshime në këto procese.

8. TRASHËGIMIA KULTUTRORE - HISTORIKE DHE TRADICIONALE

Kultura e përcakton mënyrën dhe cilësinë e jetesës në çdo shoqëri. Trashigimitë kulturore dhe historike pasqyrojnë dhe përmbajnë identitetin e një territori të caktuar dhe të njejtët paraqesin burime të pashtershme të cilët kërkojnë ruajtjen, vlerësimin dhe shfrytëzimin e tyre në bazë të parimeve të qëndrueshme. Trashëgimitë kulturore dhe historike në territorin e komunës kanë nevojë për rivlerësim dhe përpjekje për marketing dhe promovim të tyre që ato përsëri të njihen si vlera tradicionale të kësaj zone të cilat formojnë identitetin e këtij rajoni .

E gjithë kjo ka një domethënie të madhe nëse merret parasysh struktura multietnike e popullatës e cila me vete bart vlerat dhe traditat e etniteteve të tyre jashtëzakonisht të rëndësishme në rajon.

Trashëgimia kulturore përfaqëson potencial të madh turistik dhe me menaxhim cilësor mund të kontribuoj në zhvillimin e turizmit në këtë territor.

Në komunën e Tearcës nuk ekzistojnë Qendra Kulturore, vende të cilat shërbejnë për promovimin e trashëgimive kulturore historike si dhe në zhvillimin e vlerave kulturore.

Në komunën e Tearcës edhe pse nuk kemi Qendra Kulturore, vende ku do të mundësohej promovimi i traditës dhe trashëgimisë, si dhe zhvillimi i vlerave tradicionale dhe kulturore. Edhepse në komunën e Tearcës ka 9 vendbanime, rinia dhe banorët nuk kanë mundësi të vizitojnë projekcione të kinemave, nuk ka as edhe hapësirë multifunksionale e cili do të mundësonte këtë veprimtari. Deri në vitet e 80-ta në Tearcë ekzistonte ndërtesa ku edhe shfaqeshin projeksione kinematografike, por për fat të keq objekti është destinuar për veprimtari tjetër dhe më këtë veprim mundësitë për rekreacion kinematografik kanë përfunduar. Hapja e hapësirës kinematografike në Tearcë nëpërmjet ristaurimit të objektit të vjetër, ose ridestinim i hapësirës tjetër alternative prej shkollës ose objekt tjetër në hapësirë multifunksionale. Kjo do të nënkupton pajisjen e hapësirës ekzistuese me teknikës për projekcion kinematografik, zërimit dhe karrikeve lëvizëse, ndërsa hapësira të mund të shfrytëzohet edhe për destinime tjera. Të rinjtë dhe banorët tjerë do të fitonin mundësi dhe aktivitete tjera dhe njëkohësisht më shumë mundësi për aktivitete kulturore – zbavitëse.

Komuna e Tearcës edhepse nuk ka Qendra kulturore, përsëri organizohen manifestime të ndryshme me qëllim të ruajtjes së vlerave historike dhe kulturore. Sektori qytetar shpesh në bashkëpunim me vetëqeverisjen lokale ose vetëm mundohen të sjellin freski në jetesën e qytetarëve lokale me organizimin e manifestimeve të ndryshme kulturore. Megjithatë, kjo nuk është e mjaftueshme sa duhet që ruajtjen dhe promovimin e këtyre ngjarjeve kulturore në rajon .

Në territorin e komunës sonë mbahen ngjarje të ndryshme kulturore ,të cilat kanë për qëllim të bëhen tradicionale në këtë rajon.

Në këtë komunë veprojnë disa organizata qytetare, Shoqata kulturore, shoqatat për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe të ngjashme. Ato punojnë dhe veprojnë në kushte dhe hapësira të papërshtatshme , aktivitetet e tyre kryesore I zhvillojnë nëpër shkolla, restorante dhe objekte të tjera joakeduate.

Komuna e Tearcës është e pasur me monumente kulturore dhe historike, ndërtesa të mbrojtura, vende arkeologjike, kisha, manastire, xhami dhe burime tjera natyrore.

Më të njohura prej tyre janë: Bigori i Sllatinës, Xhamia e Vjetër në Tearcë, Kalaja e Leshkës, Manastiri Leshkë, Muzeu në Nerasht, v.q. Mellovë, v.q Tre Ujrat, v.q Plloça, Gështenjat e Odrit, Liqenet e Dobroshtit, Liqenet e Breznës, xhamia e vjetër në Përc ë etj.

Gjatë vitit 2019 në kuadër të projektit CBC Kosovë – RMV u organizuan disa takime pune me palë të ndryshme të interesuara në të cilat u mapuan objektet e trashëgimisë kulturore me përgaditjen e broshurës në tre gjuhë dhe u realizua projekti për rikonstruimin e mullirit të vjetër në f. Tearcë.

9. SEKTORI CIVIL

Në territorin e komunës së Tearcës veprojnë një numër i caktuar i organizatave nga sektori cilvil (joqeveritar), por vlen të theksohet se përqindja e shoqatave dhe organizatave aktive është e vogël. Janë të nevojshme intervenime konstruktive në këtë fushë, të cilët do të mundësojnë funksionimin më të mirë, përforcimin e kushteve për punë të organizatave të këtilla, ndërlidhjen me biznis sektorin, me qëllim që publiku të jetë më mirë i informuar. Por, nga ana tjetër organizatat e sektorit qytetar duhet të jenë më transparente dhe të hapura etj.

Duhet të theksohet se organizatat të cilat janë aktive, kanë bashkëpunim më të mirë me vetëqeversijen lokale OJQ - të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sferën e : zhvillimit ekonomik lokal, mjedisit jetësor, kulturës dhe traditës, mbrojtjes sociale, diskriminimin gjinor, sportit, punës me të rinj, bashkëpunimi ndërfetar, arsimit, mjedisit jetësor, këmbimi i përvojave në nivel nacional dhe ndërkombëtar etj.

10. ANALIZA E SITUATËS -

10.1. SWOT analiza

Zhvillimi shoqëror në bashkësi	
ANËT E FORTA	**ANËT E DOBËTA**
• Numër i mjaftueshëm i shkollave fillore dhe qasje deri te shkollat e mesme dhe universitetete • Pasuri etnike - popullatë multietnike • Infrastruktura eksituese në raport me ambulantat • Të rinj – popullatë e aftë për punë • Përqindje e madhe e fëmijëve në moshë 0-6 vjet	• Zvogëlimi i numrit të popullatës si shkak i emigrimit në vendet e Europës perendimore • Shkalla e lartë e papunësisë, veçanërisht te të rinjtë • Programe educative të cilët nuk janë të përshtatura me nevojat e tregut • Mosekzistimi i vetëdijes dhe dëshirës për rëndësinë e mësimit gjatë gjithë jetës • Rritja e përqindjes së personave të moshuar
MUNDËSITË	**RREZIQET**
• Afërsia e universiteteve nund të luaj rol të rëndësishëm në sigurimin e fuqisë kualitative punëtore • Sektor i zhvilluar për turizëm në komunën e Tearcës paraqet mundësi për punësim (edhe në programet e tanishme dhe reja turistike), nëpërmjet të sinergjisë me sektorët tjerë. • Potencial për përforcimin e sektorit të bujqësisë, me qëllim që të krojohen vende të reja të punës , si dhe të promovohet ndërmarrësia • Iniciativa të përbashkëta për përforcimin dhe përkrahjen e punësimit të përsonave me invaliditet nëpërmjet të promovimit të mënyrave të reja të edukimit (mësimi gjatë gjithë jetës) • Iniciativa të përbashkëta për përkrahjen e ndëramrrësve të rinj, veçanërisht nëpërmjet të parimit të vetëpunësimit • Shërbime të zhvilluara për ndihmë dhe përkujdesje të peronave të moshuar në kushte shtëpie • Mundësi për punësim dhe licencim të personave për shërbime sociale nëpërmjet të provajderëve të licencuar • Ndërtimi i çerdhes për fëmijë në vitin 2022 e cila duhetë filloj me punë në vitin 2023.	• Disbalans ndërmjet ofertës dhe kërkesës së tregut të punës • Mundësi të kufizuara për punësime të reja, kryesisht për arsye në përgjithësi të gjendjes së vështirë ekonomike. • Mosinteresimi i personave për punë në fushën sociale • Pandemia (Kovid -19) • Inflacioni • Rritja e çmimeve të energjisë dhe produkteve themelore ushqimore.

Zhvillimi rural dhe Bujqësia	
ANËT E FORTA	**ANËT E DOBËTA**
• Nga sipërfaqja e përgjithshme prej 8.629ha të komunës së Tearcës 55,34% ose 4.777 ha është tokë e punueshme • Kushte të volitshme klimatike • Tokë bujqësore jo e ndotur • Prodhimtari tradicionale bujqësore • Rrjeti ekzistues i stacioneve dhe ambulantave të veterinës • Fillimi me ndërtim i sistemit me kosto të ulët për ujitje në Tearcë • Fillimi me ndërtim i një pjese të rrugëve të fushës	• Tokë bujqësore e coptuar (parcela të vogla) • Shkallë e ulët e kualitetit të jetës në disa fshatra • Infrastrukturë e pamjaftueshme në disa fshatra • Mosekzistimi i kapaciteteve grumbulluese dhe përpunuese • Infrastruktura e pavolitshme në disa vendbanime – mosinteresimi i të rinjëve që të mbeten dhe të jetojnë në fshat • Mosekzistimi i kontrollit sistematik për përdorimin e pesticideve dhe kontrollit mbi ndotjen e sipërfaqeve bujësore • Infrastruktura e pavolitshme për qasje deri te fushat (rrugët e fushës, uji për ujitje …..) • Zvogëlimi i fondit të kafshëve dhe prodhimtarisë bujqësore
MUNDËSITË	**RREZIQET**
• Subvencione në bujqësi • Mundësi për rrjetizim në organizata të ndryshme dhe donator për edukim dhe lloj tjetër të ndihmës së bujqëve • Futja e kulturave të reja, të cilat kërkohen në treg • Nxitja e prodhimtarisë së kontraktuar • Gjetja e donatorëve për ndërtimin e infrastrukturës për qasje te sipërfaqet e punueshme bujqësore (rrugë të fushës, ujitje….) • Shfrytëzimi i mundësive financiare për financimin e sistemeve moderne për ujitje të tokave bujqësore (pikë pikë, shi artificial etj.)	• Fatkeqësit elementare, ndryshimet klimatike • Trendi i përgjithshëm i largimit të të rinjëve prej fshatit në qytet ose jashtë shtetit • Treg i pazhvilluar dhe i parregulluar i prodhimeve bujqësore • Ndotje e ujrave si pasojë e përdorimit të pakontrolluar të herbicideve dhe pesticideve në bujqësi • Rritja e çmimit të energjensëve dhe materialeve për ushqim dhe mbrojtje në bujqësi

Ambienti jetësor dhe Biodiversiteti	
ANËT E FORTA	**ANËT E DOBËTA**
• Parku Kombëtar i Malit Sharr (60%) • Mbi 280 ditë me diell • Shumëllojshmëria e mjedisit jetësor, e pasur me resurse natyrore • Pasuri me Riviera ujore • Biodiversitet me lloje të ndryshme • Sipërfaqe të mëdha me pyje • Deponija rajonale RUSINO, rajoni I Pollogut • PPP me menxhanim me mbeturinat – koncesion deri në vitin 2034	• Administrim jofunksional i Parkut Kombëtar të Malit Sharr • Zgjidhje të pamjaftueshme për mbeturinat dhe ujrat e zeza • Investime të pamjaftueshme në fushën e mbrojtjes në mjedisin ku jetojmë • Ndërgjegjësimi i ulët popullatës për mbrojtjen e mjedisit • Mospërfshirja e të gjithë fshatrave të banuara malore në grumbulllimin e mbeturinave në mënyrë të organizuar • Ujë i pijes me cilësi të dobët • Rrjet i pandërtuar i kanalizimit për ujra të zeza • Gropa septike
MUNDËSITË	**RREZIQET**
• Potencial për burime të rinovueshme të enegjisë, veçanërisht nga mbetjet bujqësore dhe mbetjet pyjore (biomasa) , • Mundësi për nisma të përbashkëta në raport me menaxhimin me mbeturinat (rajoni i Pollogut) , • Mundësia për prodhime të qëndrueshme bujqësore dhe të pyjeve, në përputhje me parimet e menaxhimit të qëndrueshëm të tokës , • Numri i madh i vendbanimeve mbulohen nga grumbullimi i organizuar i mbeturinave , • Prodhimi i energjisë elektrike nga dielli , • Ndërtimi i impianteve moderne të trajtimit me kosto të ulët që prodhojnë biogas, biomasë- mbetje organike dhe energji elektrike, • Ujë kualitativ i pijes nëpërmjet ndërtimit të stacioneve të filtrimit të ujit të pijshëm, • Sigurimi i ujit të pijshëm – ndërtimi dhe rindërtimi I rrjetit primarë shpërndarës të ujësjellësit , • Vendosja e sistemeve fotovoltaike në kulmet e objekteve publike (3x15 KW)	• Rreziqet e mundshme nga përmbytjet • Vështërsi administrative për prezantimin e planeve për burime të rinovueshme të energjisë • Shpenzime të larta për kyçjen e prodhuesve të burimeve të rinovueshme të energjisë në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike • Zona e dytë mbrojtëse Rashçe • Sëmundje nga ndotja e ujit të pijshëm • Pandemija COVID 19

Turizmi , Tradita , Pasuritë Natyrore dhe Kulturore	
ANËT E FORTA	**ANËT E DOBËTA**
• Atraksione të shumta turistike nga territori ynë • Pasuri nga historia • Tradita • Pasuri kulturore dhe natyrore • Gjeo-pozicion i mrekullueshëm • Fshatra malore • Strategjia për zhvillimin e turizmit në komunën e Tearcës • Materiale të shtypura mbi trashigiminë kulturore dhe traditën • Njësi rajonale të shoqërive alpiniste	• Potencial i pashfrytëzuar për turizëm alternativ • Mungesa e ndërgjegjësimit për brendimin e turizmit alternativ me të gjitha specifikat e tij që ofron vendndodhja gjeografike • Infrastrukturë jo mjaft e zhvilluar rrugore për zhvillim më serioz të turizmit • Mungesa e përgjithshme e standarizimit në sektorin e turizmit alternativ /rural • Burime të pamjaftueshme për mbrojtjen e pasurive natyrore , kulturore dhe historike
MUNDËSITË	**RREZIQET**
• Krijimi i atraksioneve të reja turistike • Krijimi i ofertave të reja të përbashkëta turistike • Potencial imadh për zhvillimin e turizmit alternativ (gjueti ,turizëm malor , çiklizëm, vëzhgimi i shpendëve, aventura, turizëm fetar) • Rritja e kapaciteteve të popullsisë për zhvillimin e turizmit dhe integrimin e tij në ofertën turistike • Nevoja për ngritjen e kapaciteteve të popullsisë për rëndësinë e produkteve bujqësore dhe rolin e tyre në zhvillimin e turizmit • Ruajtja e aftësive tradicionale për produkte autentike vendase, për të qenë pjesë e ofertës turistike .	• Bashkëpunim i dobët ndërmjet sektorëve të ndryshëm dhe zhvillimin e degëve turistike dhe ofertave turistike • Rrezik i mundshëm i dëmtimit të pasurive kulturore dhe historike, për shkak të kujdesit të pamjaftueshëm dhe strategjisë dhe strategjisë së qëndrueshme • Largimi jashtë vendit i kuadreve me arsim të lartë • Pandemija COVID 19

Infrastruktura dhe Transporti	
ANËT E FORTA	**ANËT E DOBËTA**
• Afërsia te rrugët kryesore magjistrale dhe regjonale • Trafiku hekurudhor • Afërsia me dy aeroportet (në vend dhe në Kosovë) • Mbulimi me energji elektrike • Mbulimi me rrjet telekomunikimi të asaj mobile dhe telefonisë fikse • Tregu i liberalizuar i ofertave për TV dhe provajder të internetit • Filloi me ndërtim rrjeti i kanalizimit në Tearcë	• Një pjesë e rrugëve janë në gjendje të pavolitshme dhe më së shpeshti përdoren për ndërlidhjen lokale, • Komunikacioni hekurudhor është në gjendje të keqe në komunën tonë dhe në të gjithë vendin • Investime të pamjaftueshme në infrastrukturën e transportit • Mungesa e mjeteve të mjaftueshme financiare për mirrëmbajtjen e rrugëve lokale • Furnizim me ujë në disa fshatra • Mosekzistimi i rrjetit të kanalizimit për largimin e ujrave të zeza • Shtretër të parregulluar të lumenjëve • Mosekzistimi i një deponie bashkëkohore • Shfrytëzimi i pamjaftueshëm i burimeve të rinovueshme të energjisë
MUNDËSITË	**RREZIQET**
• Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore • Bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar me qasje tek fondet e jashtme • Përfshirja në projekte rajonale dhe kombëtare për furnizimin me ujë , menaxhimin e mbeturinave , efikasitetin energjetik • Promovimi i përdorimit të burimeve të rinovueshme dhe efikasiteti energjetik • Përgaditja e dokumentacionit teknik për rrjetin e kanalizimit ujrave të zeza, ujësjellës ,ujrat atmosferik dhe objektet përcjellëse. • Përgaditja e dokumentacionit teknik për rrugica dhe rrugë lokale	• Burime të pamjaftueshme financiare për investime në infrastrukturën e transportit • Ndotja e mjedisit jetësorë nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve ekonomike • Shfrytëzimi i parregulltë i burimeve natyrore dhe mbrojtja e mjedisit jetësor

Resurset Njerëzore	
ANËT E FORTA	**ANËT E DOBËTA**
• Bashkëpunim i mirë rajonal • Tearca është pjesë e rajonit planor të Pollogut, për të cilën ekziston strategji • Sektori civil relativisht i zhvilluar • Komunitete të ndryshme fetare • Përqindje e madhe e popullsisë së re e aftë për punë	• Numri i pamjaftueshëm i kuadrove prefosionale në administratë • Koordinim i pamjaftueshëm me organet qendrore rreth përgjegjësive në fusha të caktuara • Mosinteresimi i sektorit të biznesit në përfshirje aktive dhe angazhimeve për përforcimin e gjendjeve në komunën tonë
MUNDËSITË	**RREZIQET**
• Ngritja e kapaciteteve në administratë (resurse njerëzore) • Shfrytëzimi i mundësive potenciale që ofron programi për bashkëpunim kufitar dhe ndërkufitar • Bashkëpunimi me diasporën - mërgatën • Shfrytëzimi i programave financiare tjera (IPA, IPARD, US dhe fonde tjera) • Përforcimi i bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik, biznesit dhe qytetarë • Harmonizimi i politikave të resurseve njerëzore me rregullativat e BE -së	• Mosbesimi i qytetarëve në institucionet publike , • Pamjaftueshmëria e burimeve për realizimin e programeve në drejtim të forcimit të kapaciteteve në administratën publike, • Përfshirja e pamjaftueshme e sektorit të biznesit në angazhimet e përbashkëta për përmirësimin e gjendjes në komunë, • Periudha e harmonizimit të dokumenteve strategjike dhe programeve me direktivat e BE , • Migrimi i popullatës në vendet e BE - liberalizimi i regjimit të vizave • Pandemija - COVID 19

10.2 PESTEL analiza

Me qëllim që ndryshimet e rrethinës të parashikohen ndryshimet në kohë dhe në mënyrë efikase, komuna e Tearcës duhet ti kuptoni edhe kushtet e jashtme. Kjo pjesë e skenimit të përmbledhjes është gjithashtu ashtu siç duhet analiza PESTEL, e cila është e vërtetë nga faktorët Politikë, Ekonomik, Socio-Kulturor, Teknologjik dhe faktori Ligjor.

Karakteristikat e faktorëve që lidhen me Komunën e Tearcës janë:

Faktorët politikë

- **Decentralizim**i – vazhdon implementimi i planit të veprimit për ndjekje të decentralizimit
  dhe përforcimi i kapaciteteve të komunave për realizimin e kompetencave ligjore. Komuna e Tearcës me sukses i kompletoi fazat e decentralizimit dhe mëtej do të ketë përforcim të kapaciteteve të administratës për realizim të kompetencave të mara nga pushteti qendror.
- јакнење на капацитетот на општите për realizimin e ligjeve të autoriteteve. Komuna Tearce me sukses i plotësoi fazit nga decentralizimi и претстои јакнење на kapacitetin e administratës për realizimin e autoriteteve të mbivendosura
- **Statusi " i Pozicionit" me Qeverinë** – Bashkëpunimi me Qeverinë, ministritë dhe insitucionet shtetërore e përcaktojnë pozicionin e vetëqeverisjes lokale në raport me qasjen në programet rajonale dhe kombëtare.
- **Eurointegrimet** – Republika e Maqedonisë së Veriut si kandidate për hyrje në BE ndërmer hapa dhe reforma, të cilat do të reflektojnë edhe mbi komunat të cilat gjithashtu do të duhet të marrin përgjegjësit e tyre për të arritur në qëllimin e përcaktuar.
- **Siguria dhe qëndrueshmëria në shtet/regjion** – 20 vitet e fundit në rajonin juglindor të Evropës, veçanërisht të Ballkanit, ishte nën ndikimin e madh të turbullirave dhe të pastabilitetit. Kjo gjendje ende nuk është më e tejkaluar, por me anëtarësimin e RMV në NATO jep garancë për sigurinë dhe stabilitetin e shtetit.

Faktorët ekonomikë

- **Investimet e huaja direkte (IHD)** - Politika e qeverisë për tërheqjen e investimeve të huaja direkte do të ndikojë edhe në investime më të mëdha në komunë. Komuna e Tearcës, me kompetencat e shtuara nga procesi i decentralizimit, tani ka mundësinë që në mënyrë të pavarur të tërheqë dhe stimulojë investimet e huaja direkte dhe të përcaktojë zona ekonomike.
- **Stabiliteti i politikës makroekonomike** - Norma e inflacionit, stabiliteti i kursit të denarit dhe shumë faktorë të tjerë makroekonomikë kanë ndikim të madh në klimën e biznesit, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal.
- **Shpenzimet për menaxhim të biznesit** - Është shumë e rëndësishme që komuna t'i zvogëlojë këto shpenzime dhe të ndajë më shumë fonde për të stimuluar biznesin. Gjithashtu, komuna duhet të ofrojë kushte të favorshme, të reduktojë procedurat për hapjen e bizneseve të reja, si dhe të implementoj me efikasitet sistemin njësportel ("one-stop shop")

- **Mbledhja e taksave dhe tatimeve** - Autoritetet qendrore dhe vendore duhet të gjejnë një mënyrë për të rritur efikasitetin në mbledhjen e tatimeve të ndryshme nga qytetarët: tatimi në pronë, tatimi në qarkullimin në pasuri të paluajtshme dhe të drejta, tatimi në trashëgimi dhe dhurata, tatimi mbi të ardhurat personale, taksa për mbishkrimin e firmës, taksa për ndriçim publik dhe lloje të tjera taksash dhe tatimesh. Suksesi i këtij procesi varet edhe nga besimi që qytetarët kanë tek pushteti vendor.
- **Kapaciteti për të tërhequr fonde nga burime të jashtme** "IPA Fonde" dhe Programet tjera nga organizatat ndërkombëtare.
- **Shpërndarja e pabarabartë e të ardhurave**. Një numër i madh i qytetarëve me të ardhura të ulëta ndikon në stimulimin dhe motivimin e tyre për edukim dhe përfshirje në tregun e punës, si dhe në fillimin e aktivitetit ekonomik.

Faktorët socio-kulturor

- **Besimi tek autoritetet -** Udhëheqja komunale duhet të udhëheqë politikë të punës profesionale dhe të jetë më aktive dhe transparente edhe në fushën e shërbimeve që i ofron, si dhe me përfshirje sa më të madhe të qytetarëve në procesin e ndërtimit të politikave për punë të mirë komunale.
- **Kujdesi i dobët për rrethinën e qytetarëve** - Kujdesi i qytetarëve për shëndetin dhe mjedisin e pastër është në nivel të ulët. Vendosja e një edukimi më të mirë dhe më aktiv (duke filluar nga më të rinjtë), dhe vendosja e mirëfilltë e sanksioneve ndaj qytetarëve dhe sektorit ekonomik, të cilat e ndotin mjedisin dhe natyrën, sigurisht që do të japin rezultate.
- **Pjesëmarrja e qytetarëve** - Përfshirja e bashkësisë mund të ndihmojë menaxhmentin komunal të punojë me një dozë të "kritikës së shëndosh". Ekzistojnë numër i madh benefitesh që mund të përfitohen nëse rritet pjesëmarrja e publikut në funksionimin e komunës.
- **Migrimet fshat-qytet dhe emigrimi jashtë vendit**. Të parët e zvogëlojnë potencialin e tyre për zhvillim, ndërsa largimi i rinisë dhe kuadrove të trajnuar shkakton mungesë të fuqisë punëtore në kushtet e rritjes së ekonomisë lokale.

Faktori teknologjik

- E – qeveria . E –qeveria është " titull i miratuar" në teknologjinë informative dhe të komunikimit në agjencionet publike dhe po transformon mënyrën se si institucionet komunikojnë me qytetarët. Përdorimi i tij premton rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të institucioneve dhe ndryshon rrënjësisht qëndrimin e tyre ndaj publikut. Përparimet në komunikim dhe përdorimi i teknologjisë luajnë një rol kyç në rritjen e standardit të jetes dhe njerëzve i'u jep fuqi më të madhe për të aksesuar të gjitha aktivitetet, por edhe për të kuptuar sistemet që u janë në dispozicion të tyre.
- Dixhitalizimi - është trend botëror që futet në të gjitha sferat e jetesës dhe punës.
- Përmirësimi i aftësive të punonjësve është çelësi për të ndjekur ndryshimet e imponuara nga dixhitalizimi.

Faktorët e mbrojtjes së mjedisit

- Efikasiteti energjetik – Çështjet e kursimit të energjisë dhe shfrytëzimit të burimeve të

rinovueshme të energjisë janë gjithnjë e më shumë objekt i punës së komunave. Vetëqeverisja lokale është e përfshirë në zbatimin e masave për arritjen e synimeve kombëtare të energjisë deri në vitin 2027;

- Ekonomia e gjelbërt dhe mbrojtja e mjedisit jetësor kanë efektet më të mëdha në nivel lokal. Ligji i ri për zonat e gjelbërta i bart kompetencat në vetëqeverisjen lokale për ndikim më të madh në këtë sektor.

Faktorët normativës ligjore

- Mundësia e realizimit të normativës më adekate lokale ligjore, taksave dhe kontributeve për mbrojtje të mjedisit jetësor,
- Qasje adekuate dhe të qëndrushme ndaj të hyrave lokale të komunës,
- Përgaditja e dokumenteve adekuate për menaxhimin me mbetjet ndërtimore,
- Menaxhimi i qëndrueshëm dhe i drejt me tokën bujqësore.

10.2 Mendimi publik prej sektorëve të ndryshëm

Opinioni i administratës së komunës

Vizioni për komunën

- Komunë me infrastrukturë të zhvilluar për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe tërheqëse për investitorët (mërgimtarët, vendas dhe të huaj)
- Administrata komunale me kapacitete të ndërtuara (ambiente pune, e pajisur me kompjuterë të rinj për çdo punonjës, softuer të përshtatshëm, kuadro të trajnuar etj.).

Probleme që duhet zgjidhur në fushat që i mbulon administrata

- Sigurimi i nivelit më të lartë të të ardhurave nëpërmjet arkëtimit në kohë të të ardhurave me angazhim më të madh të të gjithë sektorëve.
- Papunësia e të rinjve në komunën e Tearcës
- Emigrimi i të rinjve me arsim të lartë
- Përfshirja më e madhe e qytetarëve të Komunës së Tearcës në projektet e administratës komunale.
- Krijimi i një e-komune më të mirë dhe më efikase.

Aktivitete për standard më të mirë për jetesë të qytetarëve

- Investime që do të ofrojnë vende të reja pune dhe kushte më të mira jetese.
- Shtigjet për biçikleta
- Rritja e lëvizjes pa automjete
- Përmirësimi i EE të ndërtesës së komunës dhe sallës së Këshillit komunal për të përmirësuar cilësinë dhe shpejtësinë e shërbimeve që ofrojmë për qytetarët.
- Planifikimi strategjik i zhvillimit të komunës në sferën e urbanizmit, i cili do të ndjekë

infrastrukturën moderne dhe funksionale, zhvillimin teknologjik.

- Komunë e projektuar ekologjikisht sipas trendeve evropiane dhe botërore, avangarde kulturore, turistike dhe shoqërore.
- Ndërtesat individuale dhe kolektive me efikasitet energjetik ndikojnë drejtpërdrejt në buxhetin e familjes duke ulur faturat e energjisë deri në 50%.

Projektet në funksion të zhvillimit ekonomik të Komunës së Tearcës

- Investime (emigrantë, vendas dhe të huaj) që do të sigurojnë të ardhura të reja dhe vende të reja pune dhe kushte më të mira të jetës.
- Mikrobizneset; inkurajimi i zejtarëve dhe artizanateve.
- Kompani publike private për përzgjedhjen dhe riciklimin e materialeve.
- Asistencë arsimore, logjistike dhe financiare për bizneset fillestare (start-up) ,
- Projekte IPA në fushën e ekonomisë, mjedisit jetësor, sociale, arsimit dhe investimeve
- Zhvillimi dhe mbështetja e bujqësisë, blegtorisë duke mbajtur kurse intensive për ata që merren me këto aktivitete - veprimtari.
- Mësimi dhe përmirësimi i profesioneve dhe trajnimeve të tjera.

Bashkëpunimi me qytetarët, organizatat joqeveritare dhe sektorin e biznesit në Komunën e Tearcës

- Takime të shpeshta dhe konstruktive me qytetarë, përfaqësues të sektorit të biznesit dhe organizatave joqeveritare për të kuptuar idetë dhe nevojat e tyre.
- Organizimi i takimeve, trajnimeve që nuk do të tarifohen që mund të mbahen nëpër shkolla, për të papunët që janë 18 -50 vjeç për profesione të ndryshme.

Rritja e investimeve dhe punësimi në Komunën e Tearcës

- Nxitja dhe mbështetja për vetëpunësim dhe investime që synojnë sipërmarrjet e vogla dhe mikro, si dhe hapja ndaj investimeve të huaja.
- Realizimi i objekteve infrastrukturore në bashkëpunim me institucione të tjera (trajtimi i ujërave të zeza, menaxhimi i mbeturinave dhe pikat e nxehta industriale).
- Investime për formimin e një rrjeti monitorues në media për të cilat nuk është vendosur monitorim (zhurma, toka, biodiversiteti...).
- Rritja e financimit nga donatorët për projektet në fushën e mjedisit, ndryshimeve klimatike, instalimeve për prodhimin e biogazit nga mbetjet organike.
- Krijimi i masave më të volitshme dhe lirimeve tatimore për investime në Komunën e Tearcës si dhe prezantimi i tyre para investitorëve vendas dhe të huaj,
- Zgjimi i interesit si dhe mbështetje për hapjen e bizneseve private familjare.

Opinioni i OJQ-ve

Vizioni për komunën

- Një komunë, prioritet i së cilës do të jetë zhvillimi ekonomik lokal, veçanërisht zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla familjare dhe të mesme, nxitja e zejtarisë si dhe profileve të ndryshme, me trajnime të ndryshme shtesë, si dhe zhvillimi i turizmit rural dhe malor përmes turizmit malor nëpërmjet numrit të madh të bukurive natyrore që kemi dhe PK Sharri.
- Më shumë vende pune dhe numër më i madh i punësimeve në komunën e Tearcës dhe rrethinës.
- Me më shumë investime, ndërmarrje më funksionale të vogla dhe të mesme dhe më shumë vende pune

Probleme që duhet zgjidhur

- Zbatimi selektiv i ligjeve dhe përzgjedhja e kuadrove në administratën publike
- Mbështetje e pamjaftueshme si nga niveli lokal ashtu edhe nga aj qendror, mungesa e investimeve të huaja për shkak të pasigurisë në vend, interesimi i pamjaftueshëm i të rinjve për punë të pavarur si dhe niveli i interesimit të tyre për punësim në administratë, mungesa e trajnimeve shtesë. , mangësi në drejtimin në shkollat e mesme profesionale, mungesë linjash kreditore të favorshme, mungesë subvencionesh shtetërore etj.
- Migrimi i të rinjve dhe largimi (emigrimi) nga komuna.
- Tërheqja e investimeve të huaja, duke inkurajuar migrantë tanë individualisht ose të bashkuar

Aktivitete për një standard më të mirë jetese të qytetarëve

- Rritja e buxhetit komunal
- Mbështetje gjatë aplikimit për grante
- Përmirësimi i sigurisë
- Rritja e numrit të investimeve

Opinioni i anëtarëve të Këshillit të Komunës

Vizioni për bashkinë

- Komunë tërheqëse për jetë dhe punë për të gjithë gjeneratat, e inkurajuar dhe e motivuar drejt perspektivave të reja dhe më të mira
- Vend ku banorët e bashkësive të ndryshme etnike bashkëjetojnë në harmoni dhe tolerancë.

Problemet e realizimit të vizionit

- Stabilitet më i madh politik dhe tolerancë mes subjekteve politike për një përfshirje më të shpejtë në integrimet në BE.
- Ligjet që mbulojnë rregullativën ligjore të vetëqeverisjes lokale, në fushën e financimit të vetëqeverisjes lokale. Të parashikohen më shumë të hyra burimore të komunave, më saktësisht të zgjerohet korniza normative për financim më të mire - kualitativ të komunave.

- Mungesa e një koncepti strategjik, të koordinuar mes komunës, qeverisë dhe investitorëve (ekonomisë), të menaxhuar dhe zbatuar në mënyrë të vazhdueshme.
- Mungesa e lehtësimeve për investime të reja.

Aktivitete për një standard më të mirë jetese të qytetarëve

- Përmbledhja dhe përfundimi i zhvillimit komunal, infrastrukturor, social dhe arsimor; infrastrukturë komunale (ujësjellës-kanalizime) dhe rrugore dhe ndërlidhje më e mirë e vendbanimeve;
- Shfrytëzimi i potencialit për zhvillim rural dhe bujqësi,
- Të gjitha zonat e mundshme të lira me rregulime hortikulturore dhe parqe;
- Ndërtimi dhe përshtatja e hapësirës për ngjarje kulturore;
- Hapja e qendrës sportive-rekreative, hapja e qendrës kulturore-rinore,
- Dhënia e kushteve më të favorshme për sektorin e biznesit për zhvillimin e bizneseve të tyre dhe të ngjashme;

Shitet puna

- Tërheqja e investitorëve (mërgimtarëve, vendas dhe të huaj) që do të investojnë kapital në qytet dhe do të bëjnë biznese/objekte të reja biznesi.
- Trajnime për të gjithë, mundësitë e hapur për të parashtruar pyetje, propozime, sugjerime, kritika etj.
- Ofrimi dhe mbështetja e qytetarëve për vetëpunësim (shërbime konsultative, ndihmë juridike etj.), mbështetje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme vendore duke ofruar lehtësime për shfrytëzimin e tokës për ndërtim në territorin e komunës,
- Qasje te informatat për punësime të reja dhe kompani të reja Start –up

Projekte në funksion të zhvillimit ekonomik të Komunës së Tearcës

- Objekte të reja: Qendër Kulturore; Qendër sportive, Qendër sociale
- Shërbimi në komunë për: Projekte inovative dhe Programe për subvencionimin e vetëpunësimit
- Bashkëpunimi me qytetarët, organizatat joqeveritare dhe sektorin e biznesit në Komunën e Tearcës
- Takime më të shpeshta në nivele të ndryshme (mes biznesmenëve, mes qytetarëve dhe biznesmenëve, ndërmjet OJQ-ve dhe sektorit të biznesit),
- Kontakti i drejtpërdrejtë me të rinjtë e papunë

Rritja e investimeve dhe punësimi në Komunën e Tearcës

- Përfitimet për investitorët e rinj dhe planet urbanistike me zona të përcaktuara ekonomike
- Një linjë buxhetore e veçantë për OJQ-të për realizimin e projekteve të tyre.
- Komuna do të theksojë rëndësinë e pagesës së tatimeve, e cila do të rrisë mundësinë e komunës për të investuar në bashkësi si kthim të mjeteve nga komuna për qytetarët.
- Projektet ekologjike për një mjedis jetesor më të shëndetshëm,
- Deponimi, selektimi dhe riciklimi i duhur i mbeturimave;
- Trajtimi i duhur i ujërave të zeza;
- Kontrolli i emetimeve të gazrave të dëmshëm në ajër
- Të përmirësohet strehimi i rasteve sociale dhe të punësohen të gjithë ata që janë të rrezik social
- Planifikimi në arsim - shkolla e mesme dhe të larta në drejtim të aftësimit të kuadrove

që janë deficitare dhe të nevojshëm në fushat e informatikës, teknologjisë, prodhimit ushqimor, ndërtimtarisë (mjeshtërve), mekanikës etj.
- Qytetarët duhet të jenë të përfshirë dhe gjithmonë të informuar për gjërat që ndodhin në institucione.

Projektet në funksion të zhvillimit ekonomik të Komunës së Tearcës

- Promovimi më i madh i projektit "Fermeri i Ri".
- Analiza e mundësisë që ndriçimi publik të mundësohet pjesërisht nga panelet diellore.
- Fabrika për përpunimin e produkteve bujqësore
- Riciklimi i mbeturinave
- Komuna do të theksojë rëndësinë e pagesës së tatimeve, e cila do të rrit mundësinë e komunës për të investuar si kthim i mjeteve nga komuna për qytetarët.
- Projekte tashmë të përfunduara në fushën e zhvillimit ekonomik (mbështetja e bizneseve të vogla dhe të mesme, puna për një punëdhënës të njohur, motivimi i qytetarëve për të regjistruar biznesin e tyre...
- Formimi i një fond rezervë, me të cilin qytetarët do të ndihmohen për të kapërcyer më lehtë sfidat me të cilat përballen, pjesëmarrja e sektorit civil në ndarjen e fondeve të tilla.
- Krijimi i një trekëndëshi koordinues, (Vetëqeverisja Lokale, Agjencia e Punësimit dhe Sektori Civil), me synim uljen e përqindjes së lartë të papunësisë,
- Nxitja e biznesit familjar

Bashkëpunimi me qytetarët, organizatat joqeveritare dhe sektorin e biznesit në Komunën e Tearcës


- Të kemi bashkëpunim më të madh dhe të kemi takime të përbashkëta më të shpeshta me komunën
- Organizimi i takimeve, me qëllim të këmbimit të informacionit dhe ndarjes së detyrave, krijimit të projekteve të reja për të cilat mund të aplikohen bashkërisht.
- Organizimi i takimeve të rregullta me qytetarët që merren me zhvillimin ekonomik personal apo familjar, si dhe përkrahja e ideve të tyre, përmes mbështetjes financiare nga Komuna apo projekteve të përbashkëta të mbështetura nga organizata vendase dhe ndërkombëtare.
- Transparencë në vazhdimësi dhe bashkëpunim më të madh me OJQ-të;
- Rritja e bashkëpunimit në procesin e sjelljes së politikave vendore; Ofrimi i shërbimeve lokale në bashkëpunim me organizatat joqeveritare,
- Çdo organizatë joqeveritare duhet të përgatisë projekte në interes të qytetarëve dhe të njëjtat projekte të mbështeten dhe kontrollohen për realizim nga vetë donatorët për të përcaktuar rezultatet e arritura.
- Përcaktimi i një fondi për zhvillimin e qëndrueshëm të organizatave joqeveritare.
- Organizimi i aktiviteteve të ndryshme ku qytetarët dhe komuna do të komunikojnë për politikat e komunës (tryeza të rrumbullakëta, tribuna publike, ngjarje kulturore dhe sportive).

10.4 Vetëqeverisja lokale

Organet e e komunës janë Këshilli dhe Kryetari

Këshillin e përbëjnë përfaqësuesit e qytetarëve të zgjedhur në zgjedhje të përgjithshme, të lira dhe të drejtpërdrejta dhe më votim të fshehtë.
Numri i anëtarëve të Këshillit të komunës së Tearcës përcaktohet në varësi nga numri i banorëve të komunës. Për arsye se komuna e Tearcës numëron 22.454 banorë, renditet në grupin e komunave që kanë 19 anëtar nga nacionalitete dhe partive të ndryshme.
Anëtarët e Këshillit zgjidhen me mandat prej katër viteve, i përfaqësojnë qytetarët në komunë dhe në Këshill ata vendosin në bazë të bindjeve të tyre.
Përveç Këshillit, si organ tjetër menaxhues i komunës është edhe Kryetari me administratën komunale, i cili përkujdeset për zbatimin e punëve vijuese si dhe realizimin dhe zbatimin e kompetencave.

10.4.1 Struktura organizative e komunës së Tearcës[1]



Në bazë të raportit vjetor prej regjistrit të të punësuarve në sektorin publik për vitin 2021 të shpallur nga Ministaria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, numri i të punësurave me vendime me afat të pacaktuar në komunën e Tearcës ishte 41.

[1] 2016 година

10.4.2 Buxheti i komunës së Tearcës

Buxheti në komunën e Tearcës përbëhet nga zërat e të hyrave dhe të dalave ,të cilat pastaj ndahen në kategori.

Financimi i komunës është nga më shumë burime të financimit, edhe ate : burime vetanake të të hyrave, dotacione të mjeteve prej Buxhetit të R. Maqedonisë së Veriut dhe nga buxhetet e fondeve dhe huazimit.

Burime vetanake :

1. Tatimet lokale
   - Tatimi në pronë.
   - Tatimi në trashëgimi dhe dhurata
   - Tatimi në qarkullimin e patundshmërive
   - Tatime tjera loakle të përcaktuara me ligj
2. Taksa lokale :
   - Taksa komunale,
   - Taksa administrative dhe
   - Taksa tjera të përcaktuara me ligj
3. Kompensime lokale :
   - Kompensime për rregullimin e tokës ndërtimore
   - Kompensime për veprimtari komunale
   - Kompensime për plane hapësinore dhe urbanistike dhe
   - Kompensime të tjera lokale të përcaktuara me ligj
4. Të hyra nga pronësia
   - Të hyra prej qirasë
   - Të hyra nga kamatat
   - Të hyra nga shitja e pronës me të cilat nuk prishen funksionet publike dhe kompetencat e komunës.
   - Të hyrat prej donacioneve
   - Të hyra nga dënimet në para
   - Të hyrat nga vetëkontributet
   - Të hyrat tjera të përcaktuara me ligj

Dotacione prej Buxhetit të R.së Maqedonisë së Veriut :

- Të hyrat prej tatimit në vlerën e shtuar
- Dotacione të destinuara
- Dotacione kapitale
- Bllok dotacione dhe
- Dotacione për kompetenca të deleguara.

Në tabelë është treguar buxheti i komunës për vitin 2021:


Të hyra buxhetore


Të hyra të përgjithshme	**191.229.786**
Të hyra tatimore	34.243.261
Të hyra jotatimore	1.386.588
Të hyra kapitale	2.224.468
Të hyra prej dotacioneve	125.507.000

Të dala buxhetore

Të dala të përgjitshme	**195.593.529**
Me destinim të caktuar	195.428.529
Të dala prej rezervave	165.000
Deficit / Suficit	-4.363.743

Të hyra prej transferëve	26.367.779
Të hyra prej donacioneve	1.500.690






Sipas kategorive

Gjithsej	195.593.529
PAGA DHE KONTRIBUTE	136.139.376
REZERVA DHE TË DALA TË PADEFINUARA	165.000
MALLRA DHE SHËRBIME	33.701.157
SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	2.408.568
BENEFITE SOCIALE	235.667
TË DALA KAPITALE	22.943.761

Burimi : Llogaria përfundimtare për vitin 2021



Nga të dhënat e paraqitura në tabelën e paraqitur më lartë mund të vërehet se nga buxheti i përgjithshëm i komunës 69,6% janë për orientuara për paga dhe contribute, ndërsa vetëm një pjesë e vogël prej vetëm 11,73% janë të dala për investime kapitale. Si rekomandim për zhvillim të qëndrueshëm është se duhet që të rritet përqindja e mjeteve të ndara për investime kapitale dhe shërbime sociale. Njëkohësisht duhet të gjendet mënyrë për rritjen e përqindjes së arkëtimit të mjeteve burimore të komunës. Duhet të ketë kujdes në alokimin e të dalave të panevojshme dhe orientimin e tyre në investime të cilat në të ardhmën do të krijojnë të ardhura të reja ose do të zvogëlojnë shpenzimet për komunën.

10.5 Përfundime

- Karakteristikë për komunën e Tearcës është migracioni i cili është mjaft i shprehur, sidomos në rajonin planor të Pollogut është dukshëm më i madh në dekadën e fundit. Faktorët socio-ekonomikë, papunësia e popullsisë lokale, janë arsyeja kryesore për këtë situatë. Komuna e Tearcës ka migrimin më të madh , e cila në të njëjtën kohë ka popullatë të re .
- Komuna e Tearcës dhe sipërfaqja e saj përfaqësojnë territor me elemente shumë të rëndësishme nga aspekti gjeografik, relievit, klimës dhe tokës poashtu edhe nga aspekti i vlerave të krijuara: karakteristikat socio – kulturore, tradicionale, ekonomia dhe lidhja e komunikimit.
- Sipas metodologjive dhe kategorizimit të zonave rurale dhe vendbanimeve, territori i komunës së Tearcës është rural.
- Papunësia është e lartë. Duhet marë parasysh se në komunën e Tearcës kemi një përqindje të lartë të puntorëve të përkohshëm jasht vendit tonë. Migrimi në komunën tonë është me karakter tradicional, kryesisht në vendet e Evropës perendimore dhe gjithashtu zhvillohet për një kohë të gjatë dhe paraqet burim të ardhurash për popullatën e komunës së Tearcës. Punëtorët të cilët punojnë jasht vendit me dërgesat e tyrë lëvizin ekonomin në komunë dhe më gjërë. Ata janë një nga nxitësit kryesorë të zhvillimit ekonomik lokal përveç investimeve ashtu edhe turizmit, bujqësisë etj...
- Punësimi i popullatës në rajon varet kryesisht nga ofruesit e shërbimeve si dhe nga institucionet shtetërore.
- Rekomandohet që komuna e Tearcës të ofrojë kushte më të mira për investime nga punëtorët e përkohshëm, jashtë vendit, në ndërmarrjet e vogla dhe mikro ndërmarrjet. Një sektor veçanërisht i favorshëm me avantazhe krahasuese është zhvillimi rural dhe tregtia. Gjithashtu, duhet përmendur se popullsia ka nevojë për kapacitete në rritje në bujqësi, të cilat do të bëhen më konkurrues në tregjet e brendshme dhe të huaja. Gjithashtu, përveç knoë-hoë, është e nevojshme për të konsoliduar pronësinë e parcelave të punueshme dhe mikro - fermave familjare në mënyrë që të përballojë presionin ekonomik nga kapacitet industriale të mëdha.
- Arsimi në komunën e Tearcës është në nivel shumë të ulët, megjithëse është vërejtur përmirësim në infrastrukturën arsimore. Duke marë parasysh gjendjen momentale mund të konkludojmë se infrastruktura në arsimin fillor është në nivel jo të kënaqshëm dhe nuk ofrojnë kushte të volitshme për edukim. Investimi dhe modernizimi në sistemin arsimor siç është kompjuterizimi (teknologjia informative) premton ruajtjen e kapaciteteve edukativo arsimore në popullatën lokale, por të njejtat mbeten jashtë funksionit.

- Për momentin vërehet një dinamik e re në lidhje me infrastrukturën rrugore, ndërtimin e rrugëve lokale. Në të kaluarën centralizimi në ekonomin lokale ka kontribuar për krijimin e rrjetit rrugor më të mirë fshat – qytet dhe lidhjeve të vogla fshat-fshat. Kjo është një ndër problemet dhe arsyet direkt të migrimit fshat – qytet. Rënia e vetpërmbajtjes në mjediset rurale dhe mvarësia nga qytetet.
- Përmirësimi i infrastrukturës. Ngritja e një rrjeti fshat – fshat. Përmirësimi i këtij rrjeti do të mundësojë rritjen e shkëmbimit tregtar dhe me këtë të bëhet e mundur që edhe kapitali më i vogël të mbetet në komunë. Gjithashtu potencialet turistike, natyrore dhe antropogjene, do të jenë më mirë të shfrytëzuara ndërsa të ardhurat do të jenë më mirë të shpërndara /alokuara ndërmjet bizneseve private.
- Infrastruktura komunale paraqet problem të madh për komunën e Tearcës dhe rajonin e Pollogut . Mbetjet e ngurta të hedhura aktualisht në mikro deponit e egra paraqet një problem afatgjatë. Ky problem përkohësisht është zgjidhur me ndërtimin e deponisë rajonale në Rusino Gostivarë për rajonin më të gjërë të Pollogut. Prioritet i komunës është edhe ndërtimi i sistemeve për mbledhjen e ujrave të zeza ku të njejtit rrjedhin nëpër gropat septike me të cilat ndoten ujrat tokësor dhe nëntokësor në tokë, tokës dhe ajrit. Në vitin 2021 me mjete të siguruara nga ministria për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor ka filluar ndërtimi i rrjetit të kanalizimit vetëm për f. Tearcë dhe i njejti sipas planit dinamik duhet të përfundoj në vitin 2023.
- Komuna e Tearcës ka bazë të mirë për zhvillimin e bujqësisë. Sistemi arsimor ofron mundësi për zhvillimin e kuadrit teknik në këtë lëmi e cila nuk kontribon në kontuinitet në përmirsimin e kushteve dhe standardeve dhe kushteve për punë si dhe interesimi i ulët i të rinjëve për ushtrimin e veprimtarisë bujqësore.. Në nivel lokal është e nevojshme të bëhen përpjekje të konsolidojnë parcelat me kultura dhe plantacione si dhe mikro – fermat ,një proces që aktualisht drejtohet nga qeveria qendrore.
- Komuna e Tearcës mund të kontribojë në ngritjen e vetëdijes për përmirësimin e kushteve në të cilat bëhet përkujdesja dhe rritja e kafshëve, dhe drejt mundësisë për shfrytëzimin e burimeve natyrore në ushqyerjen e të njejtëve dhe ngritja e kualitetit prodhues. Është gjithashtu e nevojshme të merret në konsideratë mundësia e mbajtjes së kulturave dhe kulturave bujqësore, të cilat janë në zonat rurale, duke përdorur metoda dhe praktika nga prodhimi organik.
- Bletaria në rajon ka potencial të rritet në një degë serioze industriale që aktualisht është reduktuar në një profesion familjar. Natyra dhe distanca nga industritë ndotëse ofrojnë një trend të qetë dhe në rritje në këtë industri.
- Përveç kësaj, qeverisja lokale duhet të përfshihet në edukimin e popullatës bujqësore për mundësit të cilat fitohen me blerjen e sipërfaqjeve prodhuese bujqësore dhe mikro – firmave . Shoqata e kooperativave u ofron fermerëve mundësinë për të ulur kostot e tyre, si dhe për të rritur vëllimin dhe të ardhurat e tyre.
- Sipas aktivitetit ekonomik të popullsisë në këtë rajon, mund të vërehet se numri i popullsisë ekonomikisht aktive është më i ulët se numri i popullsisë ekonomikisht

joaktive. Nga statistikat mund të shihet se vetëm një e treta e popullsisë ekonomikisht aktive është e punësuar, gjë që sugjeron që rajoni nuk ka mundësi dhe lehtësira për punësimin e të gjithë popullsisë, e cila është ekonomikisht aktive. Prapëseprap gjatë 3 viteve të fundit ndodh fenomeni që të ketë nevoj për fuqi të aftë për punë.

- Kushtet e pavolitshme ekonomike në të cilat njerëzit jetojnë, zhvillimi i dobët i industrisë, mundësia e një jetë më të mirë dhe arsimimi më të mirë janë vetëm disa nga arsyet që çojnë në migrimin më të madh ose emigrimin e popullsisë së këtij mikro-rajon. Kjo është shprehur veçanërisht në vitet e fundit, edhe pse që nga viti 2002, shteti nuk ka kryer një regjistrim të popullsisë, i cili do të jepte numrin e saktë të popullsisë së zhvendosur. Kjo veçanërisht është e theksuar gjatë viteve të fundit dhe sipas regjistrimit të fundit të vitit 2021 numri i jorezidentëve ka arrit në 7.944 ose 31 % nga popullsia e regjistruar. Por edhe këtë vit po shohin se vazhdon trendi i shpërnguljes. Megjithatë, mikro-rajoni ka potencial të mjaftueshëm njerëzor që mund të mobilizohet dhe të kontribuojë në përpjekjet e përgjithshme për zhvillimin socio-ekonomik.
- Nga aspekti arsimor, komuna e Tearcës nuk ofron mundësi më të mëdha për edukimin e popullatës, përveç arsimit fillor.
- Komuna e Tearcës ka një aktivitet ekonomik relativisht të vogël që ndodh si rezultat i :
    - zhvillimit të dobët industrial,
    - kapaciteteve të papërdorura për zhvillimin e turizmit,
    - investime të ulëta në inovacione,
    - paga mesatare e ulët, standard i ulët,
    - norma të ulëta të PBB-së.
    - rritja e çmimit të energjensave
    - zvogëlimi i numrit të bujqëve dhe blegtorëve
    - numri i vogël i shërbimeve dhe prodhimeve me vlerë më të madhe të vlerës së shtuar

Komuna është relativisht e varfër, me shkallë të lartë të papunësisë për popullatën lokale,

- Bujqësia është një nga degët më të zhvilluara ekonomike në komunën e Tearcës, por potenciali i saj nuk është shfrytëzuar maksimalisht kushtet klimatike, relievi, ofrojnë kushte për zhvillim në sektorin e agrarit , sidomos në fushën e blegtorisë dhe kultivimin e frutave dhe perimeve.
- Komuna e Tearcës kreyesisht është e përfaqësuar nëpërmjet rrugëve rajonale të cilat relativisht janë në gjendje të mirë dhe që mundësojnë transportin e prodhimeve. Kohët e fundit, ka disa aktivitete të Agjencisë për Rrugët Shtetërore për ndërtimin e degëve të rrugëve rajonale që do të kenë një efekt pozitiv në zhvillimin ekonomik lokal.
- Pothuajse të gjitha familjet në territorin e komunës së Tearcës kanë qasje në rrjetin e energjisë elektrike dhe të telekomunikacionit të lidhura me rrjetin e ujësjellësit. Por banorët kërkojnë që të përmirësohet furnizimi dhe kualiteti i ujit për pije.
- Komuna e Tearcës ka një numër të madh të potencialeve natyrore dhe kulturore - historike për zhvillimin e turizmit.

10.6 Rekomandime

- Përgatitja e dokumenteve të veçanta strategjike që do të zbatohen nga njësitë vendore, në të cilat gjithnjë e më shumë do të përfshihen sektori civil dhe ai i biznesit me qëllim rritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
- Bashkëpunim më i madh ndërmjet vetëqeverisjes lokale të Tearcës dhe qeverisjes qëndrore, si dhe bashkëpunim me institucionet qeveritare për marrjen dhe shfrytëzimin e përfitimeve , mundësive dhe fondeve për zhvillimin e komunës.
- Ngritja e vetëdijes publike te popullata për mundësit të cilat u mundësojnë veglat bashëkohore dhe projektet për zhvillim të tyre personal dhe zhvillim të komunës. Hapja e vendeve të reja të punës nëpërmjet investimit, posaçërisht në domenin e ekonomisë lokale dhe mundësive për diversifikimin e saj. Theks i veçant duhet të vendoset në zhvillimin dhe investimin në turizëm dhe zhvillim rural si sektor të rëndësishëm për zhvillim të ekonomisë së çdo vendi.
- Investimi më i madh në çdo segment të jetës shoqëroro - sociale të cilët do të mundësonin që popullata të mbetet në shtëpitë e tyre dhe mos të mendojnë për shpërngulje jo vetëm nga rajoni , por edhe jashtë rajonit.
- Rëndësi e veçantë është përforcimi i potecialit të arsimit të mesëm profesional nëpërmjet të definimit të drejtimeve dhe profileve arsimore të reja, të cilat do të jenë si rezultat i nevojave të tregut të punës. Njëkohësisht duhet të hulumtohet mundësia e hapjes së shkollave të mesme të disperzuara ose fakulteteve për edukim të të rinjëve në përputhje me nevojat e komunës dhe rajonit në përgjithësi dhe më gjërë.
- Shfrytëzimi i potencialit njerëzor dhe orientimi i njohurive dhe shkathtësive të tyre nëpërmjet vendosjes së sistemit të mësimit gjatë gjithë jetës, rikualifikimit dhe shtimit të njohurive dhe shkathtësive si instrument për përforcimin e potencialit njerëzor në komunën e Tearcës në fushat në të cilat ekziston potenciali ekonomik që të zhvillohet.
- Përkrahje në procesin e konsolidimit të ekonomive bujqësore nëpërmjet të bujqëve lokal për orientimin e tyre në drejtim të prodhimtarisë industriale dhe bashkimit të tyre në forma të kooperativave bujqësore ose formave tjera të bashkimit me qëllim të arritjes së ekonomisë së vëllimit dhe ndjekja dhe adaptimi kah nevojat e tregut dhe trendet bashkëkohore. Nga ana e shtetit duhet që menjëherë të ndërpritet procesi i trnasformimit të tokës bujqësore në atë industriale.
- Ndërtimin e rrjetit rrugor më efikas dhe efektiv, i cili do të siguron transport më të shpejt dhe më të sigurt ndërmjet vendbanimeve të komunës së Tearcës dhe rajonit më të gjërë. Ndërtimin e rrugëve bashkëkohore rajonale dhe magjistrale të cilët do jenë lehtë të


disponueshme për të gjitha vendbanimet e rajonit dhe i cili do të siguron ndërlidhjen e tyre me rajonet tjera të shtetit.

- Zhvillimi i programit përkatës për ndërtimit në faza të rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit deri te të gjitha vendbanimet dhe familjet, nëpërmjet shfrytëzimit të fondeve në dispozicion .
- Edukimi i popullatës lokale dhe ngritja e shkathtësive të tyre për shfrytëzim të resurseve natyrore dhe antropogjene në drejtim të krijimit të ekonomisë të diversifikuar lokale dhe në drejtim të krijimit të ofertave individuale turistike duke u munduar që ato të ngriten në nivel të ofertës së integruar tursitike rajonale.
- Të shfrytëzohet potenciali lokal në drejtim të rritjes së vlerës së shtuar, e cila është është njëra prej shtyllave të zhvillimit ekonomik. Duhet të mendojmë për nxitjen e glokalizimit si masë për mbrojtjen nga globalizmi.
- Të shfrytëzohen mundësitë që i ofrojën ditët me diell në drejtim të prodhimit të energjisë elektrike dhe ujit të ngrohtë.
- Duhet të shfrytëzohet potenciali njerëzor në komunë dhe në botën e jashtme në drejtim të zhvillimit të prodhimeve inovative dhe këmbimi i përvojave për shfrytëzim më të mirë të potencialit lokal në trendet bashkëkohore për zhvillim të qëndrueshëm.
- Të shfrytëzohen resurset (materiale dhe njerëzore) të territorit të komunës për krijimin e produkteve dhe shërbimeve me vlerë të shtuar më të madhe.

11. PLANI STRATEGJIK PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL PËR KOMUNËN E TEARCËS (2023 – 2027)

Parimet kryesore për zhvillim të qëndrueshëm janë: ekonomia, mjedisi jetësor dhe mirëqenia sociale. Kjo strategji ka për qëllim që ta përmirëson konkurrencën ekonomike, të krijon prosperitet dhe jetë më kualitative për bashkësinë që jeton në territorin e komunës së Tearcës, në një mjedis të mbrojtur dhe të sigurt social. Kjo strategji i ka parasysh të tre parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe besojmë se qëllimet dhe prioritetet janë të përzgjedhura me kujdes, ndërsa si rezultat i kësaj projektet që do të jenë të financuara nga burime të ndryshme të financimit, do ta përmirësojnë mjedisin jetësor të bashkësisë dhe do ta nxisin ekonominë lokale.

Fakti që strategjia është e përgaditur sipas parimit nga posht-lart, me aktivitete –projekte, programe e qëllime të cila janë identifkuar nga ana e të gjitha palëve të interesuara, ofron hapësirë që të besohet se projektet që do të dalin nga ajo, do të inkurajojnë popullatën lokale që në mënyrë më aktive të kyçet në proces, dhe me këtë të kontribuon kah zhvillimi i qëndrueshëm i territorit.



11.1 VIZIONI

„KOMUNA E TEARCËS DERI NË VITIN 2027 ME PRODHIME KONKURRUESE RURALE, TURIZËM TË ZHVILLUAR MALOR , VLERA MULTIKULTURORE DHE TRADICIONALE DHE NDËRTIM TË RAPORTEVE TË PARTNERITETIT ME INVESTITORËT, DO TË JETË VEND ATRATAKTIV DHE EKONOMIKISHT I ZHVILLUAR“

Zhvillimi i qëndrueshëm është vlerë dhe kualifikim bazë i këtij dokumenti, ndërsa me këtë nënkuptojmë zhvillim i cili do t'i përmbush nevojat e së tashmes, por nuk do t'i rrezikon gjeneratat e ardhëshme dhe nevojat e tyre. Resurset natyrore të territorit të komunës së Tearcës paraqesin bazë për zhvillimin e përgjithshëm material dhe shoqëror. Intervenimet e propozuara do të mundësojnë përmirrësim të kushteve për punë dhe jetë më të mirë për popullatën që jeton në këtë hapësirë. Vizioni për zhvillim ekonomik lokal paraqet pajtueshmëri për ardhmërinë në preriudhën e ardhëshme 5 vjeçare. Strategjia paraqet dokument me të cilin në tërësi definohen qëllimet, prioritetet dhe projektet- masat të cilat duhet të ndërmerren në periudhën e programimit.

Vizioni për zhvillim i përgaditur në pëputhje me detyrimet të cilat dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale (Gazeta Zyrtare e RM 5/2002). Ajo është e definuar si rezultat i pjesëmarrjes participative të palëve të involvuara në procesin e planifikimit dhe në bazë të kornizës relevante ligjore, rekomandimet nga analiza e gjendjes në komunë është e harmonizuar me dokumentet kyçe zhvillimore strategjike të kësaj zone.

11.2 Misioni

Nëpërmjet forcimit të partneritetit ndërmjet sektorit publik, sektorit qytetar dhe komunitetit të biznesit në territorin e saj, komuna e Tearcës do të punon në krijimin e kushteve më të mira për zhvillim ekonomik lokal, nëpërmjet zhvillimit të konkurrencës dhe inovacioneve , krijimin e identitetit më të theksuar turistik të territorit, modernizmi i prodhimtarisë dhe shërbimeve, stërvitje profesionale dhe motivim i resurseve njerëzore, promovimi i vlerave vendore me qasje të integruar, koordinim dhe punë transparente të të gjithë aktorëve të zhvillimit në territorin e komunës së Tearcës.

11.3 Parimet dhe vlerat

Strategjia e komunës së Tearcës , udhëhiqet prej këtyre principeve :

- **Inkluzioni** – mundëson që të ketë qasje të njejtë për të gjitha grupet qëllimore,
- **Qëndrueshmëri** – kujdeset që të gjitha projektet të cilat do të financohen prej burimeve të ndryshme të financimit, t'i plotësojnë nevojat e popullatës që jetojnë në këtë territor, por gjatë kësaj mos t'i rrezikon nevojat për gjeneratat e ardhëshme.
- **Partneritet** – të veprohet sipas parimit të ndërtimit të partneriteteve, me qëllim që të arrihet vizioni i saj dhe popullata të motivohet ta kupton rolin e saj në ndërtimin e përbashkët për një shoqëri më të mirë
- **Efikasitet** – të veprohet në mënyrë konkrete për implementimin e masave të kësaj strategjie.
- **Përgjegjësi** – të ketë përgjegjësi para banorëve , që ato rregullisht të informohen, të këshillohen me popullatën dhe rregullisht të informohen për pëparimin e saj.
- **Koordinim** – të koordinohen aktivitetet dhe masat edhe me institucionet tjera në nivel rajonal dhe nacional.

11.4 Korniza strategjike

Organizimi vertikal i vendosjes hierarkike të planit strategjik është 4 nivelesh, edhe ate :

- Rezultatet,
- Qëllimet strategjike,
- Programet dhe
- Projektet , Aktivitetet

Aktivitetet janë të definuara dhe përpunuara me shembuj konkret dhe të njejtat edhe më detajisht do të përpunohet gjatë përgaditjes së programeve vjetore për realizimin e planit Strategjik.

Rezulatatet e parashikuara janë shkalla më e lartë në reazlimin e planit strategjik dhe të njejtat arrihen nëpërmjet realizimit të qëllimeve strategjike.

Qëllimet strategjike mundsojnë që resurset e territorit të komunës së Tearcës të vendosen në funksion të zhvillimet të qëndrueshëm, që në përgjithësi inkorporohen me principet e BE-së. Koncepti strategjik është i bazuar në qasjen proaktive të integrimit ekonomik dhe shoqëror të komunës dhe me qasje reale gjatë përcaktimit të qëllimeve dhe prioriteteve. Gjatë përcaktimit të qëllimeve dhe prioriteteve kishim kijdes per efektet afatgjate, masave dhe aktiviteteve afatshkurta, me qëllim që popullata lokale të kyçet në mënyrë edhe më aktive në planifikimin dhe zbatimin e strategjisë. Gjatë definimit të qëllimeve dhe prioriteteve kishim kujdes edhe për parimin e mundësive të barabarta, në kuptim të barabarsisë gjinore dhe grupeve të ndryshme.

Projektet, Aktivitetet janë përcaktuar më qëllim të realizimit të programeve – prioriteteve dhe të arrihet qëllimet dhe rezultatet e dëshiruara.

Këto janë si rezultat i pjesëmarrjes së përgjithshme të rrethit më të gjërë të palëve të interesuara të cilët kontribuan në përgaditjen e kësaj strategjie.

Rezultatet :

1. Bujqësia dhe zhvillimi rural të jenë konkurruese ne treg nëpërmjet rrjetizimit, nëpërmjet zhvillimit të resurseve njerëzore dhe inovacionit.

2. Nëpërmjet shfrytëzimit të resurseve natyrore, të zhvilllohet turizimi dhe të zgjerrohet infrastruktura rrugore deri te vendet rurale dhe turistike.

3. Nxitja e Zhvillimit Ekonomik Lokal nëpërmjet ndërtimit të raporteve të partneritetit dhe rrjetëzimit dhe bashkëpunimit rajonal, ndërkufitar dhe ndërkombëtar.

4. Bashkëpunimi me sektorin e biznesit dhe pushtetit qendror në funksion të përmirrësimit të kushteve për rritje të vlerës së shtuar

5.Aktivitete të koordinuara me institucionet tjera për tejkalimin e krizës energjetike dhe ekonomike

Literatura :

- Agjenda 2030,
- Ligji për bujqësi dhe zhvillim rural,
- Plani lokal i veprimit në mjedis – PLVM për komunën e Tearcës (2006),
- Strategjia për zhvillim ekonomik lokal (2006-2016),
- Strategjia për zhvillim ekonomik lokal (2017-2022),
- Strategjia për turizëm në komunën e Tearcës (2019-2028),
- Programe vjetore të Këshillit të komunës së Tearcës,
- Kërkesa dhe projekte prej Bashkësive Vendore (Lokale) në territorin e komunës së Tearcës,
- Kërkesa dhe projekte prej OJQ,
- Programi për zhvillim i rajonit planor të Pollogut 2021-2026,
- Plane vjetore të veprimit për rajonin planor të Pollogut,
- Plani për zhvillim të përshpejtuar ekonomik 2022-2026 (RMV),
- Enti shtetëror për statistikë – Regjistrimi 2021,
- Plani strategjik i ministrisë për Ekonomi të RMV 2022-2024,
- Strategjia nacionale për zhvilllim të qëndrueshëm në Republikën e Maqedonisë (2009-2030),
- Programi nacional për zhvillimin e mbrojtjes sociale 2022-2023,
- Programi për zhvillim të infrastrukturës rrugore (rrugëve lokale) – Ministria për transport dhe lidhje,
- Përmirësimi i shërbimeve komunale të financuara me hua prej Bankës Ndërkombëtare për Zhvillim dhe Ndërtim dhe Ministria për Financa,
- Programet e USAID-it,
- Programet e UNDP-së,
- Programet e Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe ekonomizim me Ujrat dhe IPARD,
- Programet për zhvillim të barabartë rajonal – Byroja për zhvillim rajonal, Ministria për Vetëqeverisje Lokale,
- etj.

Të ndryshme (Fotografi, lokacione, shtojca,……..)






TYKEA
KUKURUL
GUDRO

















Известување

Сектор за урбанизам и заштита на животна средина ГЕШЕЊЕ
Со наведеното Планско Програмата за
број 04-557/2021-3 од Март 2022 за
изработка на...


Чита[повеќе



Известување

Општина Теарце е во подготовка на стратегија за Локален Економски за период 2023-2027 Затоа, ВЕ покануваме сите да придонесете со ваши идеи, сугестии,забелешки и коментари за дефинирање на стратешката рамка,програми, цели или конкретни...

Чита[повеќе



ПРОФИЛ НА ОПШТИНАТА



Општина Теарце - Комуна е Теарцës

Бр.-Nr. 11-1424/1

15-09 2022 год./viti

Njoftim

Të nderuar,

Komuna e Tearces eshtë në përgatitje të strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për periudhën 2023-2027. Prandaj, JU lutemi të gjithëve që te kontribuoni me idetë tuaja, sugjerimet, vërejtjet dhe komentet në definimin e kornizes strategjike, programeve, qëllimeve apo projekteve konkrete të cilët mund t'i dërgoni në email : besim.tearca@gmail.com ose në arkivin e komunës së Tearcës.
Prania i të dhënave nga palët e interesuara do të përfundoj më datë 14.10.2022.

Debati publik do te organizohet me datë 18.10.2022 prej orës 13:00- 14:00 ne sallën e komunës .

Propozoni VIZIONIN për zhvillimin ekonomik lokal per periudhën 2023-2027 .

Fushat e identifikuara per Zhvillim Ekonomik Lokal

1. Bujqesia dhe Zhvillimi rural,
2. Turizmi ,tradita dhe kultura,
3. Infrastruktura dhe mjedisi jetësor ,
4. Inovacionet dhe efikasiteti energjetik

Departamenti për ZHEL – Komuna e Tearcës

Општина Теарце - Република Македонија

Известување

Почитувани,

Општина Теарце е во подготовка на стратегија за Локален Економски за период 2023-2027.
Затоа, ВЕ покануваме сите да придонесете со ваши идеи, сугестии, забелешки и коментари за дефинирање на стратешката рамка, програми, цели или конкретни проекти кои може да ги доставите по е мајл. besim.tearca@gmail.com или во архивата на општина Теарце.
Пријемот на податоците од заинтересираните страни ќе завршн на ден 14.10.2022год.

Јавната дебата ќе се организира на ден 18.10.2022 год. од 13:00-14:00 часот во сала на општината.

Предложете ВИЗИЈА за локалниот економски развој за период од 2023-2027.

Идентификувани области за Локален Економски Развој :

1. Земјоделие и Рурален развој
2. Туризам ,традицијата и културата
3. Инфраструктура,
4. Иновации и енергетска ефикасност

Одделение за ЛЕР – Општина Теарце

Општина Теарце - Република Македонија

Paraqitja tabela e planit strategjik

Vizioni

“ KOMUNA E TEARCËS DERI NË VITIN 2027 ME PRODHIME KONKURRUESE RURALE, TURIZËM TË ZHVILLUAR MALOR , VLERA MULTIKULTURORE DHE TRADICIONALE DHE NDËRTIM TË RAPORTEVE TË PARTNERITETIT ME INVESTITORËT, DO TË JETË VEND ATRATAKTIV DHE EKONOMIKISHT I ZHVILLUAR “

Misioni

Nëpërmjet forcimit të partneritetit ndërmjet sektorit publik, sektorit qytetar dhe komunitetit të biznesit në territorin e saj, komuna e Tearcës do të punon në krijimin e kushteve më të mira për zhvillim ekonomik lokal, nëpërmjet zhvillimit të konkurrencës dhe inovacioneve , krijimin e identitetit më të theksuar turistik të territorit, modernizmi i prodhimtarisë dhe shërbimeve, stërvitje profesionale dhe motivim i resurseve njerëzore, promovimi i vlerave vendore me qasje të integruar, koordinim dhe punë transparente të të gjithë aktorëve të zhvillimit në territorin e komunës së Tearcës.

PARAQITJA TABELARE E PLANIT STRATEGJIK PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK LOKAL PËR KOMUNËN E TEARCËS PËR PERIUDHËN KOHORE 2023 – 2027 - ME INDIKATOR

Plani strategjik me indikator

1	Bujqësia dhe zhvillimi rural të bëhen konkurues në treg nëpërmjet rrjetëzimit dhe zhvillimit të resurseve njerëzore dhe inovacioneve				Organet e realizimit	Indikatorët
	Qëllimi strategjik 1.1.	Avancimi i prodhimtarisë bujqësore dhe burimeve njerëzore				
		Program 1.1.1. Zhvillimi i bletarisë dhe prodhimtarisë bimore industriale	Projekt 1.1.1.1	Vendosja e standardeve për prodhimet nga mjalti dhe inovacionet në bletari	Bletarët, MBPU, Shoqatat e akredituara	1-3 standarde
			Projekt 1.1.1.2	Promovim i mundësive për prodhimtari të bimëve industriale	MBPU, Komuna e Tearcës, Shoqata, Blerësit	Sipas nevojës
		Program 1.1.2. Promovimi i përfitimeve nga formimi i shoqatave bujqësore	Projekt 1.1.2.1	Promovimi i përfitimeve nga shoqatat bujqësore	Bujqit individual, Ekonomitë bujqësore, Komuna e Tearcës, MBPU, etj	Bujqit individual, Ekonomitë bujqësore, Belgtorët, etj.
			Projekt 1.1.2.2	Organizimi i vizitave në agro-panaire	Bujqit, Blegtorët, Blerësit, Tregtarët, Komuna e Tearcës, MBPU, ertj	Blerësit, Tregtarët, Komuna e Tearcës, MBPU, etj.
			Projekt 1.1.2.3	Nxitja e kuadrove të reja për agrar	Komuna e Tearcës, MBPU, Shkollat etj	njëher në vit (rrjete sociale, takime direkte etj)
			Projekt 1.1.2.4	Organizimi i seminareve , punëtorive për nevojat e agrarit	Komuna e Tearcës, MBPU, Shkollat etj	njëher në vit (rrjete sociale, takime direkte etj)
		Program 1.1.3. Zhvillimi dhe modernizimi i prodhimtarisë ekologjike	Projekt 1.1.3.1	Promovimi i prodhimtarisë organike	MBPU, Shoqatat e bujqëve, komuna e Tearcës etj.	njëher në vit (rrjete sociale, takime direkte etj)
			Projekt 1.1.3.2	Nxitja e prodhimtarisë organike	MBPU, Shoqatat e bujqëve, komuna e Tearcës etj.	njëher në vit (rrjete sociale, takime direkte etj)
			Projekt 1.1.3.3	Hapja e pikave për shitje të prodhimeve organike bujqësore	Tregtarët, blerësit, komuna e Tearcës	Sipas nevojës
			Projekt 1.1.3.4	Organizimi i punëtorive për zvogëlimin e përdorimit të lëndëve kimike dhe plehrave artificial dhe promovimi i lëndëve të reja kimike dhe plehrave kimik që janë më pak të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin jetësor	MBPU, Shoqatat e bujqëve, Fakulteti i shkencave bujqësore, komuna e Tearcës etj.	njëher në vit (rrjete sociale, takime direkte etj)
		Program 1.1.4. Nxitja e prodhimtarisë të produkteve bujqësore sipas nevojave të tregut	Projekt 1.1.4.1	Studimi, mbledhja dhe analiza e të dhënave për bujqësinë	MBPU, Fakulteti i shkencave bujqësore, komuna e Tearcës etj.	Sipas nevojës

